

**INTEGRIMI I ÇËSHTJEVE TË
PAKICAVE ROME DHE SINTI
NË PUNËN E INSTITUCIONEVE
KOMBËTARE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT DHE INSTITUCIONEVE
KOMBËTARE TË BARAZISË
UDHËZUES**



**INTEGRIMI I ÇËSHTJEVE
TË PAKICAVE ROME DHE
SINTI NË PUNËN E INSTITUCIONEVE
KOMBËTARE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT DHE INSTITUCIONEVE
KOMBËTARE TË BARAZISË
UDHËZUES**



Falënderime

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dëshiron t'u shprehë mirënjohjen e saj institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe institucioneve kombëtare të barazisë, ekspertëve dhe organizatave të shoqërisë civile nga i gjithë rajoni i OSBE-së, që kontribuuan në hartimin e këtij udhëzuesi. ODIHR-i shpreh, gjithashtu, vlerësimin dhe mirënjohjen e tij të veçantë për znj. Romanița Iordache, znj. Katerina Simonova dhe z. Theodoros Alexandridis për rolin e tyre kyç në hartimin e këtij botimi.

Integrimi i Çështjeve të Pakicave Rome dhe Sinti në Punën e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Institucioneve Kombëtare të Barazisë - Udhëzues

Varshavë, 2026 OSBE/ODIHR

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

ul. Miodowa 10,
00-251 Varshavë,

Poloni

www.osce.org/odihhr

© OSCE/ODIHR 2026


Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jotregtare, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një citim të OSBE/ODIHR-it si burim.

ISBN: 978-92-9271-501-4

Përkthimi: Endrit Kokona

Redaktimi ligjor & gjuhësor: Erjola Likaj

Përgatitja grafike: Dejan Kuzmanovski



Përmbajtja

Shkurtime	5
Parathënie	6
Hyrje	8
1. Strategjitë dhe planet institucionale që kanë të bëjnë me pakicat rome dhe sinti	16
1.1 Trajtimi i çështjeve të pakicave rome dhe sinti në strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit	17
2. Punësimi dhe arsimi i vazhdueshëm profesional që trajton çështjet e pakicave rome dhe sinti	22
2.1 Kryerja e kontrolleve mbi diversitetin e personelit	22
2.2 Nxitja e punësimit dhe ngritjes në detyrë të kandidatëve otë kualifikuar me prejardhje etnike rome dhe sinti, si dhe e kandidatëve që njohin sfidat me të cilat përballen romët dhe sintët	23
2.3 Përfshirja në kodet e sjelljes e dispozitave mbi barazinë dhe detyrimin për mosdiskriminim që trajtojnë posaçërisht çështjet e romëve dhe sintëve	27
2.4 Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm profesional mbi çështjet e pakicave rome dhe sinti	29
3. Dialogu me palët e tjera të interesuara	32
3.1 Vendorsja e bashkëpunimit me palët e interesuara vendase dhe ndërkombëtare	32
3.2 Mundësia e monitorimit dhe paraqitjes së ankesave nga romët dhe sintët për rastet e diskriminimit dhe marrja e komenteve mbi punën e IKDNJ-ve dhe IKB-ve për çështjet e romëve dhe sintëve	35
3.3 Hartimi dhe miratimi i një sërë udhëzimesh dhe protokollesh të përbashkëta për parandalimin e shkeljes së të drejtave të njeriut të pakicave rome dhe sinti	38
3.4 Lufta efektive kundër “gjuhës së urrejtjes” ndaj romëve dhe sintëve	40
3.5 Forcimi i mbrojtjes ndaj diskriminimit, retorikës kundër romëve dhe sintëve, dhe “gjuhës së urrejtjes” ndaj tyre në internet	43

4. Mbrojtja ligjore e të drejtave të viktimave të diskriminimit romë dhe sinti	46
4.1 Nisja e proceseve ose ndërhyrja në rastet e diskriminimit të romëve dhe sintëve pranë gjykatave vendore dhe ndërkombëtare	46
4.2 Mbështetja për zbatimin efektiv të vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore	49
4.3 Ngritja e shërbimeve mbështetëse për viktimat e diskriminimit dhe sigurimi i qasjes në to për anëtarët e komuniteteve rome dhe sinti	52
4.4 Miratimi i protokolleve për kryerjen e monitorimit strategjik (testimi i situatës) të qasjes dhe pjesëmarrjes së romëve dhe sintëve në shërbimet publike dhe private	54
4.5 Dhënia më shumë rëndësi raportimit tek organet dhe mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut	56
Shtojca 1: Burime shtesë për IKDNJ-të dhe IKB-të	60

Shkurtime

CNCDH	Komisioni Këshillimor Kombëtar për të Drejtat e Njeriut
ECRI	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
EQUINET	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë
ENNHRI	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut
FRA	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore
GNCHR	Komisioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut i Greqisë
IRDO	Instituti për të Drejtat e Njeriut
NCCD	Këshilli Kombëtar për Luftën Kundër Diskriminimit
IKB	Institucioni Kombëtar i Barazisë
IKDNJ	Institucioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut
MYRIA	Qendra Federale e Migracionit në Belgjikë
UNIA	Qendra Ndërfederale për Mundësi të Barabarta dhe Luftën ndaj Racizmit

Parathënie

Racizmi kundër romëve dhe diskriminimi ndaj komuniteteve rome dhe sinti vazhdon të ekzistojë në forma të ndryshme në të gjithë rajonin e OSBE-së. Shpesh jemi dëshmitarë të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe praktikave raciste dhe diskriminuese, që pengojnë pjesëmarrjen e romëve dhe sintëve në të gjitha fushat e jetës.

Në vitin 2003, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së miratuan **Planin e Veprimit të OSBE-së për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintëve**. Ky dokument i kushton vëmendje të konsiderueshme luftës kundër racizmit dhe diskriminimit dhe mbështetet në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe rajonal të të drejtave të njeriut. Plani i Veprimit synon të forcojë punën e shteteve pjesëmarrëse, si dhe institucioneve dhe strukturave të OSBE-së, për të garantuar që romët dhe sintët të mund të luajnë një rol të plotë dhe të barabartë në shoqëri, dhe që diskriminimi ndaj tyre të zhduket.

Raporti më i fundit i ODIHR-it mbi Statusin e Zbatimit të Planit të Veprimit vuri në dukje një rritje të sjelljeve dhe praktikave raciste dhe diskriminuese ndaj romëve dhe sintëve gjatë viteve të fundit, duke filluar nga shkeljet e të drejtave të njeriut e deri te qëndrimet paragjyquese dhe stereotipet, si dhe që racizmi kundër romëve mbetet një mjet i spikatur për mobilizimin e grupeve të nxitura nga urrejtja, pakënaqësia dhe paragjykimet. Kjo shoqërohet me tkurrjen e hapësirës për shoqërinë civile dhe një rënie të ndjeshme të mbështetjes dhe financimit për organizatat e të drejtave të njeriut dhe ato mbikëqyrëse, të përqendruara në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e situatës së të drejtave të njeriut të romëve dhe sintëve. Për rrjedhojë, shumë organizata, që punonin më parë në këtë fushë, kanë zvogëluar numrin e aktiviteteve të tyre ose janë mbyllur. Edhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe të barazisë kanë pasur presione të ngjashme. Mungesa e personelit të kualifikuar, shkurtimet e buxhetit, fushatat e njollosjes dhe kërcënime të tjera drejtuar kundër këtyre organeve shtetërore kanë një efekt negativ të shtuar ndaj përkrahjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Për t'i trajtuar këto çështje në kohë të tilla sfiduese, ODIHR-i vazhdon të ofrojë mbështetje për mbrojtësit e të drejtave të njeriut të pakicave romë, me anë të trajnimeve, mentorimit dhe mbështetjes për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e dimensionit njerëzor. Veprimtaritë tona ofrojnë një platformë për dialog të vazhdueshëm mes organizatave të shoqërisë civile, dhe vazhdojnë t'i mbështesin shtetet pjesëmarrëse për përmirësimin e situatës së komuniteteve romë dhe sinti.

Ky udhëzues synon të ndihmojë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe institucionet kombëtare të barazisë për mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut dhe barazisë për romët dhe sintët. Këto institucione janë jetësore për të garantuar që komunitetet romë dhe sinti marrin trajtim dhe mbrojtje të drejtë sipas së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato mund të luajnë një rol të fuqishëm në luftën kundër diskriminimit, trajtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe dhënien zë atyre që kanë më shumë nevojë për të. Përmes një pune frytdhënëse me komunitetet romë dhe sinti, këto institucione mund të shembin pengesat dhe të krijojnë mundësi të barabarta, duke i dhënë formë një të ardhmeje vërtetë të barabartë.

Maria Telalian, Drejtoreshë e ODIHR-it

Hyrje

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ka mandat nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (SHP) për të monitoruar zbatimin e angazhimeve të OSBE-së për pakicat rome dhe sinti.¹ Në lidhje me luftën kundër racizmit dhe diskriminimit, **Plani i Veprimit i OSBE-së për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintëve në Rajonin e OSBE-së** (Plani i Veprimit) rekomandon që shtetet pjesëmarrëse të ngrenë institucione të specializuara për të garantuar zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit, përfshirë mekanizmat vendorë për të monitoruar dhe raportuar mbi përparimin në zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit. Plani i Veprimit vëren më tej se duhet të inkurajohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të romëve dhe sintëve në organe të tilla.² TNdaj, angazhimet e OSBE-së i inkurajojnë gjithashtu SHP-të që të ngrenë kuadrin institucional për romët, si dhe të kenë organe qeveritare në nivele të përshtatshme për të zbatuar politika dhe programe që synojnë përmirësimin e situatës së romëve dhe sintëve.³

Plani i Veprimit vëren se ODIHR-i duhet t'i mbështesë shtetet pjesëmarrëse, me kërkesën e tyre, për hartimin e legjislacionit kundër diskriminimit, si dhe për ngritjen e organeve kundër diskriminimit, dhe se ODIHR-i mund të japë këshilla se si mekanizmat ekzistues kombëtarë, siç janë zyrat e Avokatit të Popullit, komisionet kundër diskriminimit dhe komisionet disiplinore të policisë, mund të zbusin tensionet mes komuniteteve rome dhe sinti dhe atyre jorome. Në të njëjtën kohë, Plani i Veprimit i cakton ODIHR-it detyrën e “marrjes së një roli proaktiv për të analizuar masat e marra nga shtetet pjesëmarrëse, si dhe për situata e ngjarje të veçanta që lidhen me popullsinë rome dhe sinti” dhe, për këtë qëllim, të vendosë dhe zhvillojë kontakte të drejtpërdrejta me shtetet pjesëmarrëse dhe të ofrojë këshilla dhe rekomandime mbi masat në trajtimin e sfidave.⁴ ODIHR-i ka gjithashtu detyrë “të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve rome dhe sinti”, si dhe të “veprojë si faktor nxitës për shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira mes shteteve pjesëmarrëse dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.⁵

1 Këshilli Ministror i OSBE-së, **Vendimi Nr. 3/03** (MC Dec. 3/03), “Plani i Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Pakicave Rome dhe Sintë në Rajonin e OSBE-së”, Mastrit, 3 dhjetor 2003, pikat 24, 102, 125, 126 dhe 129 [anglisht].

2 Po aty.

3 Këshilli Ministror i OSBE-së, **Vendimi Nr. 6/08** (MC Dec. 6/08) “Për Shtimin e Përpjekjeve të OSBE-së për të Zbatuar Planin e Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Pakicave Rome dhe Sintë në Rajonin e OSBE-së”, Helsinki, 5 dhjetor 2008 [anglisht].

4 OSBE, **Plani i Veprimit për Romët dhe Sintët**, pikat 127, 129 [anglisht].

5 Po aty, pikat. 102, 127.

Ky udhëzues bazohet në raportin e vlerësimit të nevojave të brendshme të ODIHR-it të vitit 2021, i cili identifikoi dhe analizoi nevojat për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ) dhe institucioneve kombëtare të barazisë (IKB) për t'i trajtuar më mirë çështjet e pakicave rome dhe sinti. Udhëzuesi bazohet në parimin se IKB-të dhe IKDNJ-të luajnë rol thelbësor në nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të pakicave rome dhe sinti, dhe se të dyja llojet e organeve kanë mandate dhe kompetenca që plotësojnë njëra-tjetrën.

IKDNJ-të janë organe të pavarura, të themeluara me ligj ose kushtetutë, me rolin që të nxisin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në nivel kombëtar. Ato janë unike, sepse janë organe të themeluara nga shteti, që funksionojnë në mënyrë të pavarur nga qeveria dhe shoqëria civile. Ndaj, ato shërbejnë si urë mes shoqërisë civile dhe shtetit, sepse lidhin përgjegjësitë e shteteve me të drejtat e qytetarëve të tyre. Sipas Parimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Statusin e Institucioneve Kombëtare (Parimet e Parisit),⁶ kompetencat e IKDNJ-ve duhet të jenë sa më të gjera të jetë e mundur.⁷ Ato duhet të trajtojnë të gjitha të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

IKB-të janë organe shtetërore, shumica e të cilave u krijuan pas miratimit të Direktivës për Barazi Racore (2000/43/KE), që kërkon nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), vendet në prag të anëtarësimit dhe vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) që të ngrenë organe barazie për nxitjen e trajtimit të barabartë. Kjo u pasua nga direktiva të tjera të BE-së mbi barazinë ("Direktivat e BE-së për Trajtim të Barabartë").⁸ Ndryshe nga IKDNJ-të, mandati i IKB-ve është i kufizuar në nxitjen e barazisë dhe

6 [Rezoluta 48/143](#) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (UN GA Res 48/143) "Parimet që lidhen me Statusin e Institucioneve Kombëtare" (Parimet e Parisit), UNGA, 20 dhjetor 1993. Parimet e Parisit përmbajnë rregulla të njohura ndërkombëtarisht mbi mandatet dhe kompetencat e IKDNJ-ve. Parimet e Parisit përcaktojnë, gjithashtu, standardet minimale mbi themelimin dhe funksionimin e IKDNJ-ve dhe mbështesin parimet kryesore të pluralizmit, transparencës dhe të garantimit të pavarësisë dhe efektivitetit funksional dhe institucional të IKDNJ-ve. Zbatimi i Parimeve të Parisit dhe vlerësimi i IKDNJ-ve sipas këtyre parimeve kryhet nga Nënkomiteti për Akreditim (SCA) i Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI). SCA-ja kryen, gjithashtu, "Vëzhgime të Përgjithshme", që sqarojnë dhe shpjegojnë më tej Parimet e Parisit. Shih, [Vëzhgime të Përgjithshme](#), GANHRI SCA, 21 shkurt 2018 [anglisht].

7 Këshilli i Evropës (KIE), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (AP e OKB-së), si dhe organe të tjera, kanë nxjerrë një sërë rekomandimesh ose rezolutash më rëndësi për IKDNJ-të, përfshirë Rezolutën [48/134](#) të AP-së së OKB-së, e cila mbështet Parimet e Parisit; Rekomandimin [Rec \(97\)14](#) të Komitetit të Ministrave të KIE-së, Këshilli i Evropës, Strasburg, 30 shtator 1997; Rekomandimin [CM/Rec \(2021\)1](#) të Komitetit të Ministrave të KIE-së "Për Zhvillimin dhe forcimin e institucioneve kombëtare efektive, pluraliste dhe të pavarura të të drejtave të njeriut", Këshilli i Evropës, Strasburg, 31 mars 2021; si dhe shumë rezoluta të tjera të OKB-së mbi IKDNJ-të, e disponueshme [këtu](#) [anglisht].

8 Këshilli i Bashkimit Evropian, Direktiva [2000/43/KE](#) "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht origjinës racore ose etnike", Bashkimi Evropian, Luksemburg, 29 qershor 2000; Direktiva [2000/78/KE](#) "Krijimi i një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion", Bashkimi Evropian, Bruksel, 27 nëntor 2000; Direktiva [2004/113/KE](#) "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin me mallra dhe shërbime", Bashkimi Evropian, Bruksel, 13 dhjetor 2004; Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, [2006/54/KE](#) "Për zbatimin e parimit të mundësisë të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e riformuluar)", Bashkimi Evropian, Strasburg, 5 korrik 2006 [anglisht].

luftën ndaj diskriminimit. Ato e realizojnë këtë duke ofruar ndihmë të pavarur për viktimat për të ndjekur ankesat për raste të diskriminimit, për kryerjen e sondazheve të pavarura rreth diskriminimit, si dhe për botimin e raporteve dhe rekomandimeve.⁹

IKB-të ndryshojnë nga IKDNJ-të jo vetëm për shkak të mandatit të tyre më të kufizuar, por edhe sepse, në praktikë, “promovimi i barazisë së plotë shkon përtej të drejtave”.¹⁰ IKB-të luajnë një rol kyç, sepse jo vetëm u ofrojnë ndihmë individëve që përballen me diskriminim, por edhe sepse kombinojnë zbatimin e kuadrit rregullator dhe përpjekje për ndërtim kapacitetesh brenda mandatit të tyre. Kjo i bën ato organe të rëndësishme dhe të përshtatshme, edhe në vende që kanë IKDNJ plotësisht të pavarura dhe efektive. Ndaj, si IKDNJ-të, ashtu edhe IKB-të, mund të luajnë rol kyç në trajtimin e çështjeve të romëve dhe sintëve në nivel kombëtar. Megjithatë, është e rëndësishme që ato të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë punën mes tyre. Kjo do të parandalojë jo vetëm mbivendosjen e punës dhe shterimin e burimeve të kufizuara, por mund të forcojë dhe rrisë edhe ndikimin e veprimeve të tyre.

Ky botim synon të nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm, aftësitë dhe potencialin e IKDNJ-ve dhe IKB-ve për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut dhe barazinë për komunitetet romë dhe sinti. Ai është, gjithashtu, një përmbledhje e praktikave të mira, që synojnë të nxisin një përkushtim më të gjerë dhe më të informuar të palëve të interesuara për ta forcuar rolin e IKDNJ-ve dhe IKB-ve në trajtimin e çështjeve që hasin komunitetet romë dhe sinti. Ndërsa ky udhëzues synon së pari IKDNJ-të dhe IKB-të, ai duhet parë, gjithashtu, si një material i dobishëm për institucionet kombëtare, veçanërisht politikëbërësit, organet legjislative e gjyqësore, ministritë, si dhe shoqërinë civile romë dhe proromë, dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

9 Duhet theksuar se direktivat e BE-së për Trajtim të Barabartë ofrojnë vetëm standarde minimale për kompetencat dhe pavarësinë e kufizuar funksionale të organeve të barazisë. Ndryshe nga Parimet e Parisit, deri vonë direktivat e barazisë nuk garantonin pavarësi të plotë, efektivitet, kompetenca të mjaftueshme dhe burimet e duhura për organet e barazisë. Megjithatë, më 7 maj 2024, pas miratimit të mëparshëm në Parlamentin Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Direktiva që përcaktojnë standarde detyruese për organet e barazisë; [Direktiva e Këshillit \(BE\) 2024/1499](#) e Këshillit të Bashkimit Evropian e 7 majit 2024, mbi standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë të personave, pavarësisht origjinës së tyre racore ose etnike, trajtimi i barabartë i personave në çështjet e punësimit dhe profesionit pavarësisht nga feja ose besimi i tyre, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual, trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në çështjet e sigurimeve shoqërore dhe në qasjen dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, që ndryshon Direktivat 2000/43/KE dhe 2004/113/KE, Bashkimi Evropian, Bruksel, 29 maj 2024; dhe [Direktiva \(BE\) 2024/1500](#) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian, e 14 majit 2024, mbi standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta mes grave dhe burrave në çështjet e punësimit dhe profesionit, që ndryshon Direktivat 2006/54/KE dhe 2010/41/BE, Bashkimi Evropian, Bruksel, 29 maj 2024 [anglisht].

10 [Zhvillimi i Standardeve për Organet e Barazisë](#), EQUINET, nëntor 2016 [anglisht].

Pse është i nevojshëm ky udhëzues?

IKDNJ-të dhe IKB-të kanë një pozitë dhe përvojë profesionale unike për mbështetjen e pakicave rome dhe sinti

Pavarësisht strategjive të shumta të përfshirjes së pakicave rome dhe sinti, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ka ende “mospërputhje të thella mes situatës së komuniteteve rome dhe sinti dhe popullsisë së përgjithshme [...]. Në veçanti, diskriminimi dhe racizmi mbeten të përhapura dhe të zakonshme në retorikën politike të krahut të djathtë ekstrem. Po kështu, gratë dhe burrat romë dhe sinti ende nuk kanë mbështetjen e duhur për të marrë trajtim shëndetësor, strehim dhe punësim, të gjitha këto parakushte për të mbyllur hendekun në kuptimin më të gjerë.”¹¹ Kjo mbështetet edhe nga sondazhet, që vërejnë se një në katër romë/sinti në BE kanë raportuar se kanë përjetuar diskriminim në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme (si në rastet e kërkimit për punë apo marrjes së kujdesit shëndetësor), ndërsa vetëm 43 për qind (në krahasim me 72 për qind të joromëve) janë në punë të paguar. Po ashtu, 80 për qind e romëve janë në prag varfërie, ndërsa vetëm 17 për qind e joromëve hasen me këtë rrezik.¹² Ndaj, është e qartë se jo vetëm duhet bërë më shumë për të përmbushur të gjitha angazhimet për çështjet e pakicave rome dhe sinti, por edhe se pengesat për promovimin e barazisë për romët dhe sintët janë të një natyre strukturore.

Falë pozitës dhe përvojës së tyre të veçantë profesionale, IKB-të dhe IKDNJ-të mund të bëhen agjentë shumë të fuqishëm të ndryshimit dhe zë i fortë në përballjen me diskriminimin sistemik. Prandaj është e domosdoshme që IKDNJ-të dhe IKB-të ta zgjerojnë dhe forcojnë punën aktuale në lidhje me çështjet dhe shqetësimet e romëve dhe sintëve. Është po aq e rëndësishme që IKDNJ-të dhe IKB-të t'i trajtojnë çështjet e romëve dhe sintëve në të gjitha fushat e punës së tyre, për të trajtuar problematikën e diskriminimit me të cilën përballen këto komunitete.

11 Raporti i 4-të i Statusit: Zbatimi i Planit të Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintëve në Rajonin e OSBE-së, OSBE/ODIHR, 8 dhjetor 2023, fq. 6 [anglisht].

12 80% e romëve jetojnë në varfëri, Agjencia e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, 25 tetor 2022. Anкета u krye në tetë shtete anëtare të BE-së (Kroaci, Republika Çeke, Greqi, Hungari, Itali, Portugali, Rumani dhe Spanjë), si dhe në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi [anglisht].

IKDNJ-të dhe IKB-të kanë potencial të pashfrytëzuar

Ndërsa raporti i vlerësimit të nevojave i vitit 2021 nxori në pah punën e vlefshme të IKDNJ-ve dhe IKB-ve, ai theksoi, gjithashtu, potencialin e tyre të pashfrytëzuar në garantimin e të drejtave të romëve dhe sintëve dhe trajtimin me efektivitet të diskriminimit ndaj tyre. Çështje të veçanta që kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme janë: përfshirja e barazisë, dhe veçanërisht e çështjeve dhe shqetësimeve që kanë pakicat rome dhe sinti, në udhëzimet e brendshme, kodet e sjelljes dhe politikat e brendshme të burimeve njerëzore (të vlefshme si për IKDNJ-të, ashtu edhe për IKB-të); hartimi i udhëzuesve mbi profilizimin etnik; udhëzime mbi monitorimin e nivelit të zbatimit të vendimeve, rekomandimeve dhe opinioneve të organeve të barazisë; dhe udhëzime për kryerjen e hetimeve në terren (për shembull, për rastet e strehimit dhe veçimit në shkolla).

Këto udhëzime përqendrohen në katër përparësi, që burojnë nga mandatet dhe funksionet kryesore të IKDNJ-ve dhe IKB-ve:

1. Strategji ose plane institucionale për romët dhe sintët, ose që trajtojnë posaçërisht çështjet dhe shqetësimet e tyre;
2. Pasqyrimi i çështjeve dhe shqetësimeve të romëve dhe sintëve në përzgjedhjen e personelit dhe në arsimin e vazhdueshëm profesional;
3. Dialogu me palët e tjera të interesuara;
4. Mbrojtja ligjore e të drejtave të viktimave të diskriminimit me prejardhje nga komunitetet rome dhe sinti.

Këto udhëzime janë të një natyre të përgjithshme dhe pasqyrojnë standardet ndërkombëtare mbi punën dhe mandatin e IKDNJ-ve dhe IKB-ve, të hartuara dhe miratuara nga OKB-ja, Këshilli i Evropës (veçanërisht Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës [ECRI]) dhe, gjithnjë e më shumë, nga BE-ja. Disa IKDNJ dhe IKB, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) dhe Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET) kanë ndërmarrë tashmë në punën e tyre nisma apo kanë hartuar politika që trajtojnë çështjet që lidhen me romët dhe sintët, dhe shembuj të tillë paraqiten në të gjithë materialin.

Shumëllojshmëria e IKDNJ-ve dhe IKB-ve në terren pasqyron dallimet mes kulturave ligjore dhe kuadrit institucional të secilit shtet pjesëmarrës. Disa nga propozimet do të jenë pak a shumë të përshtatshme, në varësi të kuadrit institucional kombëtar, ndërsa disa do të jenë akoma më të përshtatshme për IKDNJ-të, IKB-të apo institucionet e tjera shtetërore (për shembull, kur procedurat e punësimit për nëpunësit civilë kryhen nga agjencitë shtetërore për nëpunësit dhe jo drejtpërdrejt nga IKDNJ-të apo IKB-të). Idealisht, IKDNJ-të dhe IKB-të, si dhe ENNHRI dhe EQUINET, duhet gjithashtu të nxisin zbatimin e pjesëve përkatëse të udhëzimeve në strukturat e tyre dhe të punojnë për të përmirësuar reagimin e tyre ndaj shqetësimeve të komuniteteve romë dhe sinti.

Metodologjia

Informacioni u mblodh përmes hulumtimeve dhe pyetësorëve të plotësuar nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) romë dhe sinti, IKDNJ-të dhe IKB-të e përzgjedhura nga rajoni i OSBE-së, si dhe nga ENNHRI dhe EQUINET. Drafti u shpërnda tek IKB-të dhe IKDNJ-të pjesëmarrëse, te ENNHRI dhe EQUINET, para se të gjithë të merrnin pjesë në seminarin përmbyllës të 5 gushtit 2024 për përmbylljen e draftit.

Për kë janë udhëzimet?

Gjetjet e vlerësimit të nevojave të vitit 2021 treguan që nxjerrja e udhëzimeve të veçanta për integrimin më të mirë të çështjeve dhe shqetësimeve të romëve dhe sintëve do të ishte e dobishme për IKDNJ-të dhe IKB-të, si dhe për palët e tjera të interesuara, si politikëbërësit, shoqëria civile romë dhe proromë dhe aktivistët e të drejtave të njeriut. Praktikrat inkurajuese të përfshira nuk janë shteruese dhe pasqyrojnë angazhimin dhe zgjidhjet krijuese në situatat e vendeve të ndryshme.

Kapitulli 1 shqyrton se si IKDNJ-të dhe IKB-të mund të përdorin përvojën e tyre profesionale për çështjet e romëve dhe sintëve në funksion të hartimit të planeve të veprimit dhe strategjive me rëndësi për romët dhe sintët. **Kapitulli 2** shqyrton mënyrën si të thellohet ekspertiza e brendshme e IKDNJ-ve dhe IKB-ve mbi çështjet rome dhe sinti, përfshirë emërimin e kandidatëve të kualifikuar romë dhe sinti. **Kapitulli 3** shqyrton se si IKDNJ-të dhe IKB-të mund të mbështeten në ekspertizën e palëve të tjera të interesuara nga fusha të ndryshme. Ai gjithashtu shqyrton se si këto institucione/organe mund të bëhen aktorë të fuqishëm në luftën kundër retorikës antirome dhe antisinti. **Kapitulli 4** paraqet një sërë mënyrash se si IKDNJ-të dhe IKB-të mund të kontribuojnë në mënyrë të frytshme në mbrojtjen e viktimave të diskriminimit nga pakicat rome dhe sinti.

PJESA 1

STRATEGJITË DHE PLANET INSTITUCIONALE QË KANË TË BËJNË ME PAKICAT ROME DHE SINTI

Nevojitet që për çështjet e diskriminimit, pabarazive dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut me të cilat përballen pakicat rome dhe sinti të ketë ndërhyrje specifike dhe të synuara, si dhe të bëhet integrimi i çështjeve dhe shqetësimeve të romëve në strategjitë dhe dokumentet e politikave publike. Në praktikë, nevoja për qasje strategjike në trajtimin e çështjeve të romëve dhe sintëve ka çuar në miratimin e disa strategjive dhe kuadrove të dedikuara për romët dhe sintët, të hartuara në nivel ndërkombëtar, evropian ose kombëtar, si për shembull, Kuadri i BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve deri në vitin 2020,¹³ kuadri strategjik i BE-së për Romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje,¹⁴ dhe Plani Strategjik i Veprimit i Këshillit të Evropës për Përfshirjen e Romëve dhe Shtegtarëve (2020-2025).¹⁵ Diskriminimi ndaj romëve dhe sintëve ka karakteristika të veçanta. Ky lloj diskriminimi, i quajtur 'anticiganizëm',¹⁶ identifikohet gjithnjë e më shumë si formë e veçantë racizmi, dhe ekzistojnë instrumente dhe dokumente të shumta që bëjnë thirrje që ai të trajtohet në mënyrë të qartë në strategjitë kombëtare të përfshirjes.¹⁷

13 Komisioni Evropian, *COM(2011) 173 final*, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshilli, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komiteti i Rajoneve, Kuadri i BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve deri në vitin 2020, Komisioni Evropian, Bruksel, 5 nëntor 2011 [anglisht].

14 Komisioni Evropian, *COM(2020) 620 final*, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Një Bashkim Barazie: Kuadri strategjik i BE-së për romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje (SWD(2020) 530 final), Bashkimi Evropian, Bruksel, 7 tetor 2020 [anglisht].

15 *Plani Strategjik i Veprimit për Përfshirjen e Romëve dhe Shtegtarëve (2020-2025)*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 22 janar 2020 [anglisht].

16 Edhe pse nuk ka konsensus në OSBE mbi termin "anticiganizëm", një numër i madh shtetesh pjesëmarrëse në OSBE dhe organizata ndërkombëtare e njohin këtë term dhe po e përdorin atë për të përshkruar racizmin kundër romëve. Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr.13 i ECRI-t e përcakton "anticiganizmin" si "formë specifike të racizmit, ideologji e bazuar në superioritetin racor, formë dehumanizimi dhe racizmi institucional e ushqyer nga diskriminimi historik, që shprehet, ndër të tjera, me anë të dhunës, gjuhës së urrejtjes shfrytëzimit, etiketimit negativ dhe llojit më flagrant të diskriminimit". Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës, *Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr.13 i ECRI-t*, miratuar më 24 qershor 2011 dhe ndryshuar më 1 dhjetor 2020. Për më shumë informacion rreth këtij termi shih: Këshilli i Evropës, *Anticiganizmi /Diskriminimi - Romët dhe Shtegtarët*; Komisioni Evropian, *Anticiganizmi: Rritja e Njohjes për të Kuptuar dhe Trajtuar më Mirë Shfaqjet e tija*, nëntor 2018; Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit, *Çfarë është diskriminimi kundër ciganizmit/kundër romëve?*; Aleanca kundër Anticiganizmit, *Anticiganizmi – punim referues* [anglisht].

17 *Parlamenti Evropian, Rezoluta e 17 shtatorit 2020 për Zbatimin e Strategjive Kombëtare të Integritimit të Romëve: Lufta kundër qëndrimeve negative ndaj popullsisë me prejardhje rome në Evropë*, 17 shtator 2020, pika 17. Lufta kundër 'anticiganizmit' dhe diskriminimit është një nga objektivat (dhe, në fakt, i pari) i Kuadrit Strategjik të Bashkimit Evropian mbi romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje për vitet 2020-2030, Bruksel, 7 tetor 2020, fq.4 [anglisht].

Rumania dhe Spanja kanë miratuar legjislacion të veçantë për ‘anticiganizmin’. Parlamenti rumun ka miratuar propozimin ligjor të një deputeti rom për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Anticiganizmit. Ky ligj parashikon vepra të veçanta penale kundër romëve, të ndara nga ato të parashikuara nga legjislacioni ekzistues që ndëshkon ‘gjuhën e urrejtjes’ dhe krimet e urrejtjes.¹⁸ Në Spanjë, në vitin 2022, u miratua Ligji i ri për Trajtim të Barabartë dhe Mosdiskriminim¹⁹, në të cilin ‘anticiganizmi’ parashikohet për herë të parë si rrethanë rënduese në krimet e urrejtjes. Kjo solli ndryshimin e Kodit Penal, që e cilësoi ‘anticiganizmin’ si krim urrejtjeje.^{20, 21}

1.1 Trajtimi i çështjeve të pakicave rome dhe sinti në strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit

Duke njohur rëndësinë e dhënies së përparësisë çështjeve të romëve dhe sintëve, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të luajnë **rol proaktiv në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare për romët**, dhe t’i kenë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tyre specifike në këtë fushë, të mbështetura me burime dhe të monitoruara, sipas objektivave të caktuara strategjike kombëtare. Si kuadri strategjik i BE-së për romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, ashtu edhe Rekomandimi i Këshillit i vitit 2021 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve,²² propozojnë përfshirjen e organeve të barazisë në strukturat e ngritura për të mbikëqyrur zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e kuadrove strategjike kombëtare për romët.

18 Për më shumë informacion shih: Ligji Nr.2, datë 4 janar 2021, "Për disa masa për të parandaluar dhe luftuar anticiganizmin" [rumanisht].

19 Shih: Kongresi miraton Propozimin për Ligjin Organik plotësues të Ligjit Gjithëpërfshirës për Trajtim të Barabartë dhe Mosdiskriminim, dhe ia dërgon atë Senatit – Kongresit të Deputetëve [spanjisht].

20 OSBE/ODIHR, Raporti i 4-t i Statusit, fq.27 [anglisht].

21 Pas ngritjes së Komisionit kundër Anticiganizmit në Suedi në vitin 2016, Gjermania ngriti, gjithashtu, një Komision të Pavarur për Anticiganizmin dhe krijoi pozicionin e Komisionerit për Anticiganizmin nën Qeverinë Federale. Në vitin 2021, ky komision nxori një raport 800-faqësh, që analizozi racizmin strukturor të rrënjosur në histori kundër romëve dhe sintëve në Gjermani, si dhe racizmin e vazhdueshëm në fusha të ndryshme të shoqërisë, nga prodhimi i informacionit e deri te zbatimi i ligjit. Për më shumë informacion, shih OSBE/ODIHR, Raporti i 4-t i Statusit, fq.27 [anglisht].

22 Këshilli i Bashkimit Evropian, Rekomandimi 2021/C 93/01 "Për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve", BE, Bruksel, 19 mars 2021 [anglisht].

Mbrojtësi i të Drejtave në Francë raportoi se kontribuoi në zhvillimin e Strategjisë së re franceze për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve.²³ Po kështu, **Komisioni Këshillimor Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në Francë** (*Commission nationale consultative des droits de l'homme [CNCDH]*) vuri në dukje se ishte konsultuar gjatë hartimit të Planit të ri Kombëtar të Veprimit kundër Racizmit dhe Antisemitizmit, i cili do të ketë një pjesë mbi 'anticiganizmin' dhe do duhet të pasqyrojë disa nga rekomandimet e bëra nga CNCDH-ja në të shkuarën. Gjithashtu, është në mandatin e CNCDH-së të vlerësojë Planin Kombëtar të Veprimit çdo tre vjet.²⁴

Avokati i Popullit në Shqipëri raportoi se ishte angazhuar gjerësisht në procesin që çoi në miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, dhe vlerësoi se rekomandimet e bëra nga institucioni u pasqyruan në një masë të caktuar në planin e veprimit.²⁵

Këshilli për Eliminimin e Diskriminimit Racor ose Etnik në Spanjë mori pjesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Popullsisë Rome (2021-2030), duke paraqitur nevojat e identifikuar nga Këshilli, si për shembull, nevojën për të nxitur debatin që të dhënat të mbledhen të ndara sipas origjinës etnike në studime, statistika ose raporte, si dhe për të forcuar mekanizmat që trajtojnë, mbështesin dhe mbrojnë viktimat e diskriminimit.²⁶

Njohja dhe dhënia përparësi e çështjeve që kanë të bëjnë me romët dhe sintët duhet gjithashtu të çojë në **integrimin e këtyre çështjeve në strategjitë kombëtare të barazisë, strategjitë kombëtare të të drejtave të njeriut, strategjitë institucionale dhe planet e veprimit të IKB-ve dhe IKDNJ-ve**. Miratimi i politikave, në formën e strategjive kombëtare të barazisë, të të drejtave të njeriut apo strategjive institucionale, është një mjet për të siguruar efektivitetin e IKB-ve dhe IKDNJ-ve në përgjithësi.²⁷ Zgjedhja nga ana e një shteti që të miratojë strategji ose plan kombëtar për të drejtat e njeriut, strategji për barazinë dhe mosdiskriminimin, strategji institucionale për IKB-të dhe IKDNJ-të, ose plan

23 Avokati i Popullit në Francë, përgjigje ndaj pyetësorit.

24 CNCDH-ja e Francës, përgjigje ndaj pyetësorit.

25 Avokati i Popullit të Shqipërisë, përgjigje ndaj pyetësorit.

26 Përgjigja ndaj pyetësorit e Këshillit për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe Etnik në Spanjë.

27 Komisioni Evropian, *COM/2022/689 final*, Propozim për një Direktivë të Këshillit mbi standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë të personave, pavarësisht origjinës së tyre racore ose etnike, trajtimit të barabartë të personave në fushën e punësimit dhe profesionit pavarësisht nga feja ose besimi i tyre, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual, trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në çështjet e sigurimeve shoqërore dhe në qasjen dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, dhe shfuqizimit të Nenit 13 të Direktivës 2000/43/KE dhe Nenit 12 të Direktivës 2004/113/KE, BE, Bruksel, 7 dhjetor 2022 [anglisht].

specifik veprimi për romët dhe sintët, të dala nga strategjitë e përgjithshme, varet nga politikat dhe kuadri institucional i shtetit përkatës. Konteksti kombëtar do të përcaktojë, gjithashtu, nëse do zgjidhet të hartohen objektiva ose kapituj specifikë për romët dhe sintët, apo nëse çështjet e romëve dhe sintëve do trajtohen në të gjitha fushat e punës së tyre, të integruara brenda objektivave strategjike më të gjerë dhe të përgjithshëm.

Është po aq e rëndësishme të garantohet **koordinimi** i strategjive **me strategjitë kombëtare për romët dhe sintët, përmes referimeve të ndërsjella, harmonizimit të objektivave strategjike, bashkërendimit të përgjegjësiave dhe bërjen bashkë të burimeve**. Kjo punë duhet të shoqërohet gjithashtu nga vlerësime të rregullta dhe të pavarura për të siguruar përmbushjen e objektivave. Kjo duhet të sjellë përmirësimin e punës dhe të kontribuojë në strategjitë e ardhshme.

Raportet vjetore të **Avokatit të Popullit në Spanjë** përfshijnë një seksion të veçantë mbi aktivitetet e tij për çështjet e romëve në kapitullin për barazinë.²⁸

Në kuadër të miratimit të Strategjisë së re për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve, **Mbrojtësi i të Drejtave në Francë** realizoi dy studime mbi punën e këtij institucioni në lidhje me shtegtarët dhe migrantët romë,²⁹ që përfshinin konsultime me institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe seminare për të vlerësuar vështirësitë me të cilat ata përballen në qasjen dhe gëzimin e të drejtave të tyre themelore.

Po kështu, **Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë në Irlandë** u takua me Rrjetin Kombëtar të Romëve të Irlandës në mënyrë që komisionerët dhe stafi të mësonin drejtpërdrejt mbi çështjet kryesore dhe rekomandimet për ndryshim nga përfaqësuesit e romëve dhe aktivistët në mbrojtje të komunitetit, me qëllim që ata të kontribuonin në hartimin e Deklaratës së ardhshme të Strategjisë së Komisionit.

28 Përgjigja nga Avokati i Popullit në Spanjë.

29 Raport – Shtegtarët: rrëzimi i pengesave ndaj të drejtave, Mbrojtësi i të Drejtave, 6 tetor 2021, për shtegtarët, dhe Raport - Për mbrojtjen efektive të të drejtave të romëve, Mbrojtësi i të Drejtave, dhjetor 2021 [frëngjisht].

Është e rëndësishme t'u kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të grave dhe të rinjve romë dhe sinti. IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të sigurojnë që ndërthurja e diskriminimeve³⁰ të trajtohet në mënyrën e duhur.³¹

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet gjithashtu të përfshijnë një pasqyrë të punës së tyre mbi çështjet e romëve dhe sintëve në raportet e tyre vjetore, duke trajtuar rekomandimet e bëra në vitet e mëparshme, nivelin e zbatimit të tyre, dhe analizën e asaj që po pengon zbatimin.

30 Ndërthurja e diskriminimeve është një koncept i krijuar nga studiuesja ligjore Kimberlé Crenshaw, që thekson se si aspekte të ndryshme të identitetit të personit, si "raca", gjinia, shtresa klasore, seksualiteti, aftësia, ndërthuren dhe bashkëveprojnë, shpesh duke krijuar përvoja unike të diskriminimit ose privilegjit. Termi nënkupton që individët mund të përjetojnë njëkohësisht forma të shumëfishta shtypjeje ose privilegji, dhe se këto aspekte të identitetit nuk mund të ndahen ose të kuptohen të izoluara. Në thelb, ndërthurja e diskriminimeve thekson natyrën e ndërlidhur të kategorizimeve shoqërore dhe nevojën për të shqyrtuar se si ato ndërthuren për të formësuar përvojat dhe mundësitë e njerëzve.

31 Shih, për analogji, *Manualin mbi të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut*, OSBE/ODIHR, Varshavë, 4 dhjetor 2012, fq.50. Për sfidat e veçanta me të cilat përballen gratë rome dhe sinti shih *Vendimin Nr.4/13 të Këshillit Ministror të OSBE-së*, (MC Dec. 4/13), "Forcimi i Përpjekjeve të OSBE-së për të Zbatuar Planin e Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintëve në Rajonin e OSBE-së, me Vëmendje të Veçantë ndaj Grave, të Rinjve dhe Fëmijëve Romë dhe Sinti", OSBE, Kiev, 6 dhjetor 2013 [anglisht].

PJESA 2

PUNËSIMI DHE ARSIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL QË TRAJTON ÇËSHTJET E PAKICAVE ROME DHE SINTI

IKDNJ-të dhe IKB-të janë pararojë në trajtimin me efektshmëri të diskriminimit dhe pabarazisë në nivel kombëtar. Ndikimi i tyre mund të rritet duke shërbyer si model për institucionet e tjera publike ose private. Besueshmëria dhe efektiviteti i IKDNJ-ve ose IKB-ve mund të cenohen nëse punonjësit e tyre shfaqin paragjykime dhe i trajtojnë ndryshe romët. Këto mund të shmangen duke filluar nga procesi i marrjes në punë, krijimit të një mjedisi pune të sigurt për të gjithë, dhe të siguruarit se personeli e kupton, identifikon dhe e trajton diskriminimin ose shkeljet e të drejtave të njeriut që cenojnë romët dhe sintët.

2.1 Kryerja e kontrolleve mbi diversitetin e personelit

Hapi i parë është të kuptohet struktura ekzistuese e personelit dhe të sigurohet që ajo pasqyron larminë e shoqërisë, përfshirë romët dhe sintët, dhe veçanërisht gratë rome dhe sinti, që shpesh përballen me diskriminim të ndërthurur (për shembull, për shkak të gjinisë, origjinës etnike dhe statusit socio-ekonomik). IKDNJ-të dhe IKB-të duhet **të kryejnë kontrolle të diversitetit të personelit** për të kuptuar origjinën racore ose etnike, gjininë ose larminë e personelit të tyre. Kjo i jep mundësi institucionit të përshtasë politikat e marrjes në punë, të vendosë objektiva mbi larminë e personelit, të hartojë materiale referuese për procedurat e rekrutimit ose provimet periodike, si dhe të zhvillojë kuadrin për arsim të vazhdueshëm profesional.

Këto institucione duhet gjithashtu të kryejnë rregullisht **sondazhe mbi qëndrimet dhe perceptimet** e personelit të tyre ndaj grupeve të ndryshme të cënueshme. Ka dëshmi nga burime jozyrtare se ka paragjykime për romët dhe sintët edhe në radhët e personelit të IKDNJ-ve/IKB-ve. Rezultatet e këtyre sondazheve duhet t'i ndihmojnë IKDNJ-të dhe IKB-të të përmirësojnë programet e tyre të edukimit të vazhdueshëm profesional, në mënyrë që personat që punojnë me viktimat e diskriminimit të jenë të vetëdijshëm për paragjykimet e tyre dhe të mos sillen në ndonjë mënyrë që mund të shkaktojë riviktimizim.³²

2.2 Nxitja e punësimit dhe ngritjes në detyrë të kandidatëve të kualifikuar me prejardhje etnike rome dhe sinti, si dhe e kandidatëve që njohin sfidat me të cilat përballen romët dhe sintët

IKDNJ-të dhe IKB-të mund të ndërmarrin hapa për të nxitur së brendshmi dhe në të gjithë sektorin publik marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë të kandidatëve të kualifikuar me origjinë rome dhe sinti, ose të atyre që i njohin sfidat e romëve dhe sintëve. Trajnimet dhe specializimet në detyrë mund të ndihmojnë për ta mbajtur stafin të përditësuar mbi sfidat, politikat dhe praktikatat më të mira. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional mund të përbëhet nga seminare të përshtatura, bashkëpunim ndërsektorial dhe bashkërendim me organizatat dhe ekspertët e shoqërisë civile rome dhe sinti për të rritur ndërgjegjësimin kulturor dhe njohjen mbi pengesat e shkaktuara nga sistemi. Përveç kësaj, specializimi në fusha të tilla si, e drejta kundër diskriminimit, strategjitë e përfshirjes sociale dhe hartimi i politikave me pjesëmarrje, mund ta ndihmojë stafin të hartojë dhe zbatojë masa të efektshme, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në ligj. Stafi duhet gjithashtu të ketë një kuptim më të thellë të çështjeve ndërsektoriale, çka u jep IKDNJ-ve dhe IKB-ve mundësinë për t'iu përgjigjur në mënyrë dinamike nevojave dhe prirjeve në formim e sipër.

Institucionet mund të ndërmarrin masa pozitive për të përmirësuar larminë e bazës së kandidatëve të tyre ose të vendosin kuota, sipas legjisllacionit kombëtar dhe rezultateve të kontroleve mbi diversitetin. Në fakt, disa shtete pjesëmarrëse kanë ndërmarrë tashmë hapa për të siguruar që në IKDNJ-të

32 Për të mësuar më shumë se si të intervistohen viktimat e diskriminimit, por edhe mbi shkelje të tjera të të drejtave të njeriut, shih FreedomLab, [Intervistim i Bazuar në Njohuritë mbi Traumat: Aftësi dhe Teknika për Monitoruesit](#) (trajnim online), 13 janar 2023 [anglisht].

dhe IKB-të e tyre janë të emëruar punonjës romë dhe sinti, për të përfituar nga ekspertiza dhe përvoja e tyre jetësore.³³

Kjo qasje bazohet në Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme nr.13 të ECRI-t për Luftën kundër Anticiganizmit dhe Diskriminimit të Romëve³⁴, si dhe në standardet e tjera të propozuara nga Këshilli i Evropës.³⁵ Kohët e fundit, Këshilli i Evropës ka theksuar rëndësinë e marrjes së masave të tilla të përkohshme e të veçanta, veçanërisht për punësimin e grave rome dhe sinti në sektorin publik.³⁶

Një rekomandim bazë është që **të publikohen të gjitha vendet e lira të punës në sa më shumë kanale të ndryshme komunikimi që të jetë e mundur**, përfshirë grupet elektronike ose faqet e internetit të lidhura me komunitetet rome dhe sinti. Kjo duhet të rrisë numrin dhe larminë e kandidatëve që aplikojnë për çdo pozicion, përfshirë pozicionet e larta drejtuese. Një fushatë e gjerë rekrutimi duhet të ndihmojë në tërheqjen e kandidatëve të kualifikuar me origjinë rome dhe sinti. Një qasje tjetër është vendosja e **mesazheve kyçe në njoftimet e rekrutimit, që theksojnë gjithëpërfshirjen në vendin e punës**, dhe duke nxitur kështu aplikimin e kandidatëve me prejardhje të ndryshme.

Në njoftimin standard të **EQUINET-it** për vende të lira pune thuhet:

“Sekretariati i EQUINET-it është një punëdhënës që ofron mundësi të barabarta dhe është i përkushtuar ndaj mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, fesë ose besimit, racës ose etnisë, moshës ose aftësisë së kufizuar. Me synimin për të kontribuar në arritjen e barazisë së plotë në praktikë dhe për të trajtuar pabarazitë, ai zbaton masa afirmative. Duke marrë parasysh përbërjen e stafit të Sekretariatit të EQUINET-it, në rast se ka kandidatë njëloj të kualifikuar dhe të përshtatshëm për pozicionin, do të zgjidhet personi me prejardhje etnike nga minoritetet dhe/ose me aftësi të kufizuara, përveçse nëse ka faktorë të tjerë që janë në favor të kandidatit/kandidatëve të tjerë.”

33 OSBE/ODIHR, [Raporti i 4-ti i Statusit](#) [anglisht].

34 ECRI, [Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr.13 Për Luftën kundër Anticiganizmit dhe Diskriminimit ndaj Romëve](#), CRI(2011)Rec37, i ndryshuar më 1 dhjetor 2020, parimi 5.d [anglisht].

35 Komiteti i Ministrave, [Rekomandimi Rec \(2001\)17 "Për përmirësimin e situatës ekonomike dhe të punësimin të Romëve/Ciganëve dhe Shtegtarëve në Evropë"](#), Këshilli i Evropës, Strasburg, 27 nëntor 2001, Parimi 15: "ndaj, duhet të nxitet punësimi i romëve/ciganëve në të gjitha nivelet e sektorit publik dhe të krijohen partneritete me romët/ciganët vendas, me qëllim që t'u ofrohet atyre trajnim në vendin e punës. Nëse është e nevojshme, duhet të hartohen strategji për të rritur mundësinë e punësimin të romëve/ciganëve përmes përgatitjes së aftësive të përgjithshme." [anglisht]

36 Komiteti i Ministrave, [Rekomandimi CM/Rec \(2024\)1 "Për barazinë e grave dhe vajzave rome dhe shtegtare"](#), Këshilli i Evropës, Strasburg, 5 prill 2024, pika 36 [anglisht].

Në rastin e zgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të IKDNJ-ve dhe IKB-ve, një mënyrë veprimi është **të inkurajohet zgjedhja e kandidatëve nga pakicat ose të kërkohet që kandidatët të kenë përvojë të dëshmuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë.**

Parlamenti në Rumani ka detyrimin ligjor të vlerësojë aftësitë dhe kualifikimet e aplikuesve për anëtarë të Bordit Drejtues të **Këshillit Kombëtar për Luftën kundër Diskriminimit (NCCD)**, dhe duhet të marrë parasysh përfshirjen e tyre në nisma në fushën e të drejtave të njeriut. Në teori, kjo mund të jetë përvojë pune në çështjet që kanë të bëjnë me romët dhe sintët. Në vitin 2022 u ndryshua Ligji kundër Diskriminimit për ta rritur numrin e anëtarëve të Bordit Drejtues të NCCD-së nga nëntë në njëmbëdhjetë anëtarë, dhe për të garantuar përfshirjen në të të përfaqësuesve nga pakicat kombëtare. Që nga themelimi i tij, Bordi Drejtues i organit rumun të barazisë ka përfshirë persona që dihet publikisht që janë me prejardhje romë ose me përvojë të gjerë në mbështetjen e të drejtave të romëve.³⁷

Një mënyrë tjetër për të siguruar që stafi i IKDNJ-ve dhe IKB-ve i kupton veçoritë e romëve dhe sintëve është **përfshirja e materialeve referuese në procesin e rekrutimeve**, si dispozita ligjore dhe politika, si dhe praktika gjyqësore në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, përfshirë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe vendimet e organeve të traktateve në OKB, siç janë Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD), Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD). Në veçanti, kur procesi i përzgjedhjes nuk kryhet drejtpërdrejt nga IKDNJ-të dhe IKB-të, **materialet bazë të konkurseve të pranimit për nëpunësit civilë duhet të përfshijnë legjislacionin kundër diskriminimit dhe vendimet kryesore gjyqësore për rastet e romëve dhe sintëve.** IKB-të luajnë rol kyç në zgjedhjen e materialeve referuese, por edhe në mbështetjen e agjencive kombëtare të rekrutimit, për të siguruar që formulimet mbi diversitetin dhe gjithëpërfshirjen, përfshirë ato mbi paragjykimet e pavetëdijshme, janë pjesë e **programit të rishikuar për trajnimin e intervistuesve**, dhe që vetë komisionet e përzgjedhjes janë të larmishme dhe të paanshme. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka nxjerrë një rekomandim veçanërisht të dobishëm që thekson nevojën për “trajnim mbi antidiskriminimin të personave

37 NCCD-ja e Rumanisë, përgjigje ndaj pyetësorit.

të përfshirë në vendimet e rekrutimit në sektorët privatë dhe publikë dhe në shërbimet kombëtare të punësimit”.³⁸

Proceset e përzgjedhjes së institucionit të **Avokatit të Popullit në Greqi** kryhen përmes Këshillit Kombëtar për Rekrutimin në sektorin publik. Kandidatët përzgjidhen dhe vlerësohen nëse plotësojnë kërkesat ligjore për pozicione të caktuara dhe nëse janë të përshtatshëm për pozicionin. Nëse plotësojnë kërkesat e nevojshme, në procedurën e vlerësimit kandidatëve u merren në shqyrtim përvoja dhe njohuritë mbi çështjet e romëve dhe sintëve, ose mbi çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Avokati i Popullit i Greqisë përmendi dhënien përparësi të kandidatëve nga pakicat rome, si dhe kandidatëve nga grupe të tjera të cënueshme, për pozicionin e trajnimit në Zyrën e Avokatit të Popullit.³⁹

Aktivitet tjetër me efektivitet i burimeve njerëzore brenda IKDNJ-ve dhe IKB-ve është ofrimi i **programeve të trajnimit, zhvillimit dhe lidërshiptit për kandidatët romë**, përfshirë trajnime/praktika profesionale për të forcuar integrimin e tyre në këto institucione. Programe të tilla, jo vetëm që u ofrojnë stafit rom dhe sinti njohuri dhe aftësi të vlefshme, por bëjnë gjithashtu të mundur që IKDNJ-të dhe IKB-të të përfitojnë nga njohuritë e drejtpërdrejta të praktikantëve mbi çështjet me të cilat përballen komunitetet e tyre.

Në vitin 2017, **Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore nisi një Program Trajnimi Praktik, që përfshin një skemë praktike profesionale për romët**, që synon kryesisht studentët e sapodiplomuar me prejardhje rome. Ndër të tjera, programi synon t'i informojë praktikantët romë mbi mandatin dhe rolin e Agjencisë, si dhe t'u ofrojë atyre mundësinë për të vënë në praktikë njohuritë që kanë marrë gjatë studimeve.⁴⁰ 'I trajnuari për Përfshirjen e Romëve' është program i ngjashëm nga **Grantet e Zonës Ekonomike Evropiane** (Grantet EEA), që u ofrohet studentëve të diplomuar romë dhe sinti.⁴¹ **Socialistët dhe Demokratët (S&D)**, grupim politik i Parlamentit Evropian, ka

38 Komiteti i Ministrave, **Rekomandimi Rec (2001)17**, pika 34 [anglisht].

39 Avokati i Popullit në Greqi, përgjigje ndaj pyetësorit.

40 FRA, **Vendimi CS/024/2017, Rregullat që rregullojnë Programin e Trajnimit për Romët në FRA**, Vjenë, 2017 [anglisht].

41 Grantet EEA, **Ref. 22-184**, Përshkrimi i Strukturës Organizative të FMO-së [Zyra e Mekanizmit Financiar] dhe Pozicionet e Praktikantëve në të 2022-2023; Grantet EEA, **VA 02/2022**, Praktikë në Grantet FMO-EEA dhe Norvegji 2022-2023 [anglisht].

zhvilluar, gjithashtu, gjashtë programe trajnimi pesëmujore. S&D ka krijuar një fond të veçantë për të rinjtë me origjinë rome (kandidatët duhet të jetë pjesë e komunitetit rom), për të bërë të mundur që të rinjtë romë të kenë qasje në program.⁴²

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi, në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve, zhvilloi një program praktike pune për studentët romë. Një nga pjesëmarrësit, student i ri i drejtësisë nga pakica rome, u punësua më pas në zyrën e Komisionerit dhe tani punon si këshilltar për shqyrtimin e ankesave për diskriminim.⁴³

2.3 Përfshirja në kodet e sjelljes e dispozitave mbi barazinë dhe detyrimin për mosdiskriminim që trajtojnë posaçërisht çështjet e romëve dhe sintëve

Kodet e sjelljes, si instrumente me karakter vullnetar që pasqyrojnë standardet minimale të sjelljes së pranueshme dhe vlerat thelbësore të një institucioni, përfshirë këtu larminë e stafit (fuqinë punëtore, përfituesit, klientët dhe partnerët), janë thelbësore për t'i dhënë formë mjedisit të punës dhe për ta bërë atë gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë.⁴⁴ Elementet minimale të çdo kodi sjelljeje duhet të përfshijnë:

- Deklaratën se barazia dhe mosdiskriminimi janë vlera themelore të institucionit;
- Politikë të qartë që toleranca është zero ndaj diskriminimit në nivel institucional;
- Një listë të grupeve të cenueshme që rrezikojnë veçanërisht të diskriminohen në shtetin përkatës pjesëmarrës;
- Përkufizim të “veprave penale”;
- Mekanizëm të brendshëm ankimi, të sigurt, konfidencial dhe të efektshëm, me sanksione të qarta për shkeljet;
- Sistem vlerësimi

42 [Fondi për të rinjtë me origjinë rome](#), faqja në rrjet e grupit politik të Socialistëve dhe Demokratëve të Parlamentit Evropian [anglisht].

43 Përgjigja nga Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi.

44 Łukasz Bojarski, Isabelle Chopin, Barbara Cohen, Uyen Do, Lilla Farkas dhe Romanița Iordache, [Seminare ndërgjegjësimi mbi mosdiskriminimin dhe barazinë për OSHC-të në 32 vende evropiane – Manual Trajnimi për Diskriminimin](#), Konsulenca Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Grupi i Politikave të Migracionit, maj 2012 [anglisht].

EQUINET-i ndjek një ‘politikë për hapësira më të sigurta’ në aktivitetet e tij, e cila mbulon të gjitha elementet e diskriminimit dhe ngacmimit. Brenda Sekretariatit të EQUINET-it ekzistojnë gjithashtu politika të brendshme për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri raporton se ka udhëzime të brendshme që synojnë barazinë dhe mosdiskriminimin në të gjitha fushat e mbrojtura.⁴⁵

IKB-të janë në pozicionin më të përshtatshëm **për të shpërndarë kode model të sjelljes sipas legjislacionit përkatës për mosdiskriminimin dhe barazinë**, për t’i ndihmuar punëdhënësit dhe punëmarrësit e tjerë që të kuptojnë detyrimet e tyre ligjore, dhe për të ofruar udhëzime mbi atë që punëdhënësit ose ofruesit e shërbimeve duhet të bëjnë për të respektuar legjislacionin kundër diskriminimit.

Në vitin 2014, **Avokati i Popullit në Greqi** botoi “Respect makes the difference” (Respekti bën dallimin),⁴⁶ një udhëzues mbi trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin, drejtuar të gjithë nëpunësve civilë, përfshirë edhe stafin e tij. Një version i rishikuar i udhëzuesit u botua në vitin 2017.

45 Përgjigja ndaj pyetësorit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri.

46 Συνήγορος του Πολίτη, *Οδηγός Ένας Μεταχείρισης – Εγχειρίδιο για Δημόσιους Υπαλλήλους – Ο Σεβασμός κάνει τη διαφορά* (Avokati i Popullit në Greqi, Udhëzues për të gjithë nëpunësit civilë për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim— Respekti bën dallimin”), Athinë, 2017 [greqisht].

2.4 Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm profesional mbi çështjet e pakicave rome dhe sinti

Pas marrjes në punë, është po aq e rëndësishme të ofrohet për stafin **trajnim i vazhdueshëm në punë mbi historinë, kulturën dhe gjuhën e romëve dhe sintëve, si dhe mbi të drejtat e tyre**. Si ECRI, ashtu edhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, kanë rekomanduar që shtetet anëtare të BE-së të ofrojnë trajnime mbi mosdiskriminimin, barazinë, racizmin dhe ‘anticiganizmin’ për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, si dhe për të gjithë zyrtarët përkatës qeveritarë dhe nëpunësit civilë (si, mësuesit, punonjësit e rendit publik, profesionistët e kujdesit shëndetësor, punonjësit socialë).⁴⁷ Ky rekomandim vlen edhe për stafin e IKDNJ-ve dhe IKB-ve, por u jep gjithashtu këtyre institucioneve mundësinë të jenë shembull në edukimin e nëpunësve të tjerë civilë.

Sondazhet e rregullta mbi qëndrimet dhe perceptimet e publikut të gjerë ndaj grupeve të cënueshme, si dhe sondazhet e brendshme mbi paragjykimet e stafit, mund të shërbejnë si bazë referimi për fushën e trajnimit të vazhdueshëm profesional të stafit.

Duhet të paktën të zhvillohen rregullisht kurse trajnimi me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të romëve dhe sintëve. Ato duhet të shpjegojnë veçoritë e komuniteteve rome dhe sinti, duke trajtuar pengesat për pjesëmarrjen e romëve dhe sintëve dhe gëzimin në mënyrë të efektshme të të drejtave të njeriut nga ana e tyre. Aktivitetet që janë ndërvepruese dhe/ose ndjekin modelin “Biblioteka e Gjallë” (Living Library),⁴⁸ ndihmojnë në krijimin e një njohjeje siç duhet të kulturës dhe identitetit rom dhe sinti. Ato gjithashtu duhet t’i përditësojnë pjesëmarrësit mbi dokumentet dhe jurisprudencën më të fundit ndërkombëtare, në veçanti mbi praktikën gjyqësore të kohëve të fundit të GJEDNJ-së.

Kur nuk ka burime të mjaftueshme për të organizuar kurse të veçanta mbi të drejtat e romëve dhe sintëve, institucionet mund të organizojnë kurse të mbikëqyrura përmes **platformës HELP në internet të Këshillit të Evropës**,⁴⁹ e cila ofrohet falas në anglisht dhe në gjuhë të tjera. Kurset përfshijnë: mosdiskriminimin,

47 Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), [CRI\(2012\)48](#) Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr.14 Për Luftën kundër Racizmit dhe Diskriminimit Racor në Punësim, Këshilli i Evropës, Strasburg, 25 shtator 2012. Shih gjithashtu, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi [CM/Rec\(2008\)5](#) “Për politikat për Romët dhe/ose Shtegtarët në Evropë”, Këshilli i Evropës, Strasburg, 20 shkurt 2008 [anglisht].

48 Për më shumë informacion rreth konceptit të Bibliotekës së Gjallë, shihni [Këshilli i Evropës - Biblioteka e Gjallë](#) [anglisht].

49 [Kurset HELP](#) [anglisht].

luftën kundër racizmit, ksenofobisë, homofobisë dhe transfobisë, si dhe krimet dhe gjuhën e urrejtjes.⁵⁰

CNCDH-ja e Francës vëren se trajnimi i veçantë, të paktën vjetor, është i detyrueshëm për stafin e saj.⁵¹

Pavarësisht se ka burime financiare shumë të kufizuara, **EQUINET-i** raportoi një qasje proaktive ndaj trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional. Ai inkurajon stafin e vet të marrë pjesë, gjatë orarit të punës, në kurset dhe seminarët e shumta falas për çështjet e barazisë (përfshirë edhe çështjet e romëve dhe sintëve), qoftë të organizuara nga EQUINET-i apo nga palë të tjera.

NCCD-ja në Rumani raportoi se, në vitin 2019, në kuadër të programit JUSTROM të zbatuar nga Këshilli i Evropës në Rumani, u organizua një kurs trajnimi për të përditësuar anëtarët e stafit të **NCCD-së** mbi zhvillimet më të fundit në fushën e mosdiskriminimit, veçanërisht mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED), mbi standardet më të rëndësishme për çështjet e romëve, lirinë e shprehjes dhe 'gjuhën e urrejtjes', si dhe për të shkëmbyer pikëpamje mbi praktikat që lidhen me çështjet e romëve dhe mosdiskriminimin.⁵²

50 Përveç edukimit mbi historinë, kulturën, gjuhën, si dhe të drejtat e romëve, mund të jetë gjithashtu e rëndësishme për anëtarët e stafit të IKDNJ-ve dhe IKB-ve të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në integrimin gjinor, Parimet e Parisit, diversitetin, pluralizmin dhe bashkëpunimin me OSHC-të, këshillimin për politikëbërësit, bashkëpunimin me qytetet dhe rajonet, si dhe aftësitë e përgjithshme të komunikimit dhe mbrojtjes së interesave. Për më shumë informacion, vizitoni një seri seminaresh online mbi këto tema, ODHR/ENNHRI, [Aftësitë dhe mjetet e komunikimit për Institucionet Kombëtare të Drejtave të Njeriut](#) [anglisht].

51 CNCDH-ja e Francës, përgjigje ndaj pyetësorit.

52 NCCD-ja e Rumanisë, përgjigje ndaj pyetësorit.

PJESA 3

DIALOGU ME PALËT E TJERA TË INTERESUARA

3.1 Vendosja e bashkëpunimit me palët e interesuara vendase dhe ndërkombëtare

IKDNJ-të dhe IKB-të tashmë zotërojnë informacione dhe përvojë të konsiderueshme profesionale mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me romët dhe sintët. Megjithatë, duket se ka pak kanale dhe procedura të strukturuar siç duhet për ndërveprim të dyanshëm (jo thjesht komunikim) mes palëve të interesit, duke filluar nga OSHC-të vendase e deri te organizatat ndërkombëtare. Për më tepër, dhe pa nënvlerësuar rëndësinë e saj, përfshirja formale e IKDNJ-ve dhe IKB-ve shpesh shihet si e kufizuar vetëm në dhënien e kontributit për hartimin e politikave për romët dhe sintët, dhe jo në zbatimin apo në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të tyre, fushë ku IKDNJ-të dhe IKB-të mund të japin një kontribut të rëndësishëm.

Kjo ngre tri çështje kryesore. Së pari, palët e tjera të interesuara mund të mos kenë mjaftueshëm dijeni mbi gjetjet dhe rekomandimet e IKDNJ-ve dhe IKB-ve, dhe për rrjedhojë nuk i pasqyrojnë ato në aktivitetet e tyre, çka mund të dëmtojë cilësinë dhe efektivitetin e tyre të përgjithshëm. Së dyti, mungesa e dijenisë mbi punën e bërë tashmë nga IKDNJ-të dhe IKB-të rrezikon të çojë në mbivendosje të punës nga palët e tjera të interesuara, duke shkaktuar humbje kohe dhe burimesh të çmuara. Së treti, mospërfshirja zyrtarisht e IKDNJ-ve dhe IKB-ve në shqyrtimin dhe vlerësimin e politikave për romët dhe sintët në veçanti, rrezikon që çdo mangësi ose pengesë në zbatim të mos vërehet dhe të mos trajtohet.

Komisioni Evropian ka ngritur shqetësime të ngjashme, duke vënë në dukje se në shumë raste IKB-të kanë ndërvepruar kryesisht me aktorët joshtetërorë (si organizatat e shoqërisë civile dhe akademikët) në mënyrë joformale dhe rast pas rasti, në vend të një dialogu të strukturuar. Përveç kësaj, autoritetet publike shpesh nuk i kanë përfshirë zyrtarisht IKB-të në hartimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare për integrimin e romëve. Për rrjedhojë, angazhimi i IKB-ve me aktorët si qeveritarë ashtu edhe joqeveritarë, ka mbetur kryesisht joformal, duke kufizuar ndikimin e tyre në hartimin e politikave.⁵³ Për ta trajtuar këtë çështje, në propozimin e tij për një Rekomandim të Këshillit mbi barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve, Komisioni Evropian ka përfshirë një seksion të veçantë mbi rolin e IKB-ve në promovimin e integritit social të romëve dhe sintëve.⁵⁴ Gjithashtu, vërehet se sipas Rregullores (BE) 2021/1060, pritet që IKB-të të bashkëpunojnë me OSHC-të në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e kornizave strategjike kombëtare për barazinë gjinore.⁵⁵ Në të njëjtën kohë, përkatësisht përmes ENNIHR-it dhe EQUINET-it, IKDNJ-të dhe IKB-të kanë filluar tashmë të ndërmarrin hapa për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, sfidave dhe zgjidhjeve. Nisma të tilla jo vetëm që duhet të përforcohen (për shembull, duke krijuar platforma ose duke zhvilluar takime të rregullta për ndarjen e përvojave), por duhet të krijohen edhe kanale të drejtpërdrejta komunikimi dhe bashkëpunimi mes IKDNJ-ve/IKB-ve që përballen me probleme të ngjashme. Për shembull, IKDNJ-të/IKB-të në vendet fqinje që punojnë kundër trafikimit të romëve dhe sintëve mund ta përdorin një platformë të tillë për të shkëmbyer informacione në fusha të caktuara në mënyrë që të punojnë më me efikasitet.

53 Komisioni Evropian, COM/2021/139 final, Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi zbatimin e Direktivës së Këshillit 2000/43/KE që zbaton parimin e trajtimit të barabartë të personave pavarësisht nga origjina racore ose etnike ("Direktiva për Barazinë Racore"), dhe të Direktivës së Këshillit 2000/78/KE, që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (Direktiva për Barazinë në Punësim), Bashkimi Evropian, Bruksel, 19 shkurt 2021, pika 4.3 [anglisht].

54 Komisioni Evropian, COM(2020) 621 Final, Propozim për Rekomandim të Këshillit mbi barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve, Bashkimi Evropian, Bruksel, 7 tetor 2020, rekomandimet 14-15. Rekomandimet u morën përfundimisht në konsideratë nga Këshilli i Bashkimit Evropian në Rekomandimin e tij 2021/C93/01, "Mbi barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve", Bashkimi Evropian, Bruksel, 12 mars 2021 [anglisht].

55 Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 qershorit 2021, që parashikon dispozita të përbashkëta mbi Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit të Drejtë dhe Fondin Evropian Detar, të Peshkimit dhe Akuakulturës, rregullat financiare për to dhe për Fondin e Azilit, Migracionit dhe Integritit, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetje Financiare për Menaxhimin e Kufijve dhe Politikën e Vizave, Bashkimi Evropian, Bruksel, 30 qershor 2021, Shtojca 4 [anglisht].

Ndërsa aktorët e tjerë (veçanërisht ata qeveritarë) duhet të marrin nismën dhe t'u drejtohen IKDNJ-ve dhe IKB-ve për të krijuar forma më të ngushta bashkëpunimi, ka shumë të ngjarë që kjo të mos ndodhë për një sërë arsyesh, duke filluar nga rezistenca burokratike ndaj ndryshimit, e deri te kuptimi i kufizuar i roleve të tyre. IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të synojnë të ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me një gamë të gjerë të palëve të interesuara.⁵⁶

Është thelbësore që IKDNJ-të dhe IKB-të **të identifikojnë palët kryesore shtetërore dhe joshtetërore dhe të nisin bashkëpunim të strukturuar, koordinim dhe shkëmbim informacioni mbi çështjet e romëve dhe sintëve, pa cenuar pavarësinë e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme që IKDNJ-të dhe IKB-të të jenë në gjendje të luajnë një rol më aktiv në vlerësimin e ndikimit të strategjive kombëtare për romët dhe sintët, duke dalluar mangësitë në zbatimin e tyre dhe duke dhënë rekomandime për t'i trajtuar ato.** Për këtë qëllim, IKB-të në veçanti, duhet t'u japin përparësi më të lartë çështjeve që kanë të bëjnë me romët dhe sintët kur shqyrtojnë zbatimin e kornizave kombëtare të barazisë gjinore, ku ato tashmë kanë mandat të qartë.

EQUINET-i ka bërë tashmë përparim duke siguruar që njohuritë dhe përvojat profesionale të anëtarëve të saj mbi çështjet e romëve dhe sintëve janë mbledhur dhe vënë në dispozicion Komisionit Evropian. Grupi i tij i Punës për Hartimin e Politikave përgatiti një raport të titulluar “Perspektivë” (Perspective), që paraqet çështjet kryesore me të cilat përballen romët dhe sintët, rekomandimet për trajtimin e tyre, dhe praktikave të mira të zbatuara nga anëtarët e saj.⁵⁷

ENNHRI trajton çështjet përkatëse të romëve dhe sintëve përmes **Grupit të tij të Punës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**. Grupi i Punës vepron si qendër për ekspertët dhe si një platformë për shkëmbimin e informacionit, praktikave të mira dhe sfidave me të cilat përballen IKDNJ-të në këtë fushë. Grupi i Punës gjithashtu koordinon ndërveprimin me aktorët rajonalë në BE dhe Këshillin e Evropës dhe, në një farë mase, në OKB.⁵⁸

56 Për më shumë informacion se si të angazhoheni me palët e interesuara dhe të ndërtoni aleanca, shihni Mjetin Udhëzues mbi Forcimin e Qëndrueshmërisë së Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, OSBE/ODIHR, 26 gusht 2022, fq. 21-22 [anglisht].

57 Përfshirja e Romëve dhe Shtetgarëve: Drejt një Kuadri të Ri të BE-së. Mësimet nga Puna e Organeve të Barazisë, EQUINET, 23 korrik 2020 [anglisht].

58 Përgjigje nga ENNHRI.

CNCDH-ja në Francë dha kontribut në Projekt-planin Kombëtar të Veprimit kundër Racizmit dhe Antisemitizmit, i cili ka një seksion mbi 'anticiganizmin'. CNCDH-ja ka mandatin të kryejë vlerësimin e Planit Kombëtar të Veprimit çdo tre vjet dhe, për rrjedhojë, edhe vlerësimin e masave për luftën ndaj 'anticiganizmit'. Ata raportuan, gjithashtu, se kanë një marrëdhënie të ngushtë pune me DIHAL-in (Delegacioni Ndërmator për Banim dhe Mundësinë për Strehim, i cili është gjithashtu Pika Kombëtare e Kontaktit për Romët në Francë) për çështjet e pastrimit të zonave të varfra dhe regjistrimit në shkolla, dhe me DILCRAH-in (Delegacioni Ndërmator për Luftën Kundër Racizmit, Antisemitizmit dhe Urrejtes ndaj LGBT-ve) për hartimin dhe vlerësimin e planit kombëtar të veprimit kundër racizmit dhe antisemitizmit.⁵⁹

3.2 Mundësia e monitorimit dhe paraqitjes së ankesave nga romët dhe sintët për rastet e diskriminimit dhe marrja e komenteve mbi punën e IKDNJ-ve dhe IKB-ve për çështjet e romëve dhe sintëve

Në vitin 2014, Komisioni Evropian theksoi raportimin e pakët të rasteve të diskriminimit, si dhe mungesën e njohjes së viktimave me të drejtat e tyre dhe mjetet juridike në dispozicion të tyre.⁶⁰ Komisioni Evropian i risolli këto çështje në raportin e tij të vitit 2021.⁶¹ Kjo tregon që arsyet e raportimit të ulët janë strukturore dhe se masat dhe aktivitetet e ndryshme të ndërgjegjësimit të publikut nuk kanë qenë frytdhënëse në inkurajimin e njerëzve që përjetojnë diskriminim që të përdorin procedurat e ndryshme (përfshirë paraqitjen e ankesave pranë IKB-ve).

Ndaj, është thelbësore jo vetëm që të merren **masa më të qëllimshme për rritjen e ndërgjegjësimit mbi romët dhe sintët, por edhe të identifikohen dhe të trajtohen OSHC-të rome dhe sinti për t'i ndihmuar ato të bëhen 'pika kontakti'** për romët dhe sintët në rastet e diskriminimit dhe për referimin

59 CNCDH-ja në Francë, përgjigje ndaj pyetësorit.

60 Komisioni Evropian, COM/2014/02 final Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin – Raport i Përbashkët mbi zbatimin e Direktivës së Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave, pavarësisht origjinës racore ose etnike ('Direktiva për Barazinë Racore') dhe të Direktivës së Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion ('Direktiva për Barazinë në Punësim'), Bashkimi Evropian, Bruksel, 17 janar 2014, seksioni 3.3 [anglisht].

61 Komisioni Evropian, COM/2021/139 final, Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi zbatimin e Direktivës së Këshillit 2000/43/KE Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht, origjinës racore ose etnike ('Direktiva për Barazinë Raciale') dhe të Direktivës së Këshillit 2000/78/KE Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion ('Direktiva për Barazinë në Punësim'), Bashkimi Evropian, Bruksel, 19 Mars 2021 [anglisht].

e mëtejshëm të IKDNJ-të dhe IKB-të. Në të njëjtën kohë, dhe për të siguruar pjesëmarrjen e vërtetë të komuniteteve në terren dhe OSHC-ve rome dhe sinti, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të mbajnë lidhje të drejtpërdrejta me komunitetet rome dhe sinti, për shembull, përmes vizitave të rregullta për mbledhjen e fakteve, të pashoqëruar nga anëtarët e OSHC-ve rome dhe sinti. Është veçanërisht inkurajuese që shumë nga IKDNJ-të dhe IKB-të e anketuara raportuan se ofrojnë trajnime për OSHC-të rome dhe sinti, kryesisht mbi ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre dhe paraqitjen e ankesave. Në varësi të nivelit të njohurive dhe aftësive të OSHC-ve rome dhe sinti, ky trajnim duhet të përfshijë udhëzime mbi tema të ndryshme, si format e ndryshme të diskriminimit (përfshirë “gjuhën e urrejtjes”), mbledhjen e të dhënave në mbështetje të pretendimeve për diskriminim, mjetet ligjore në dispozicion, praktikat e kohëve të fundit të gjykatave vendase/IKB-ve mbi rastet e diskriminimit, mbështetja dhe ndihma për viktimat e diskriminimit dhe ndihma juridike në dispozicion.

Komisioni i Barazisë për Irlandën e Veriut drejton një klinikë për të drejtat e njeriut, që ofron këshillim ligjor, informacione shtesë dhe referim të shërbimit e ndihmës juridike për viktimat e diskriminimit.

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të kërkojnë në mënyrë aktive dhe të rregullt mendimet e OSHC-ve rome dhe sinti, si dhe të përfaqësuesve të komuniteteve rome dhe sinti, mbi përparësitë dhe rekomandimet e tyre për pasurimin e aktiviteteve dhe trajtimin më frytdhënës të çështjeve të romëve dhe sintëve. Ata mund të konsiderojnë ngritjen e bordeve/komisioneve këshillimore dhe të ftojnë OSHC-të rome dhe sinti ose ekspertë të pavarur që t’u bashkohen, ose mund të zhvillojnë takime të rregullta dhe të hapura për konsultime të caktuara.

Në të gjitha këto nisma, duhen bërë përpjekje të veçanta për të siguruar përfshirjen e grave rome dhe sinti. Sipas Sondazhit për Romët të vitit 2021, zhvilluar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), më shumë burra romë dhe sinti sesa gra kanë dijeni se ekziston të paktën një institucion i barazisë.⁶²

62 FRA, Romët në 10 Vende Evropiane: Rezultatet kryesore – Sondazhi për Romët 2021, Vjenë, 2022, fq. 32 [anglisht].

Avokati i Popullit i Shqipërisë ofron trajnime për të rinjtë romë mbi të drejtat e njeriut dhe rolin e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, dhe planifikon të bashkëpunojë me OSHC-të dhe individët romë për të ngritur një rrjet ndërmjetësish.⁶³

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi ka ndërmarrë një gamë të gjerë masash në përgjigje të raportimit të pamjaftueshëm, duke përfshirë: trajnime për këshillat kombëtare për pakicat (përfshirë pakicën kombëtare rome), vizita dhe fushata ndërgjegjësimiti në vendbanimet joformale rome, botime në gjuhën rome mbi identifikimin dhe raportimin e diskriminimit, bashkëpunim me organizatat që punojnë për të drejtat e romëve, botim i udhëzuesve dhe trajnime për organizatat e shoqërisë civile mbi kryerjen e testimit të situatës dhe ndjekjen e çështjeve në rrugë gjyqësore, si dhe ndjekja strategjike e çështjeve në rrugë gjyqësore.⁶⁴

Këshilli për Eliminimin e Diskriminimit Racor ose Etnik në Spanjë mbështet një Shërbim Ndihme për Viktimat e Diskriminimit Racor ose Etnik. Ky shërbim menaxhohet nga *Fundación Secretariado Gitano* në bashkëpunim me shtatë OJQ të tjera, të specializuara në çështjet e migracionit dhe luftën kundër racizmit dhe mostolerancës. Stafi i tyre teknik ka përfituar nga trajnime të ofruara nga **Avokati i Popullit në Spanjë** mbi çështjet e diskriminimit, ndërhyrjen në rastet e diskriminimit, si dhe mbi rolin e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe paraqitjen e ankesave. Shërbimi ofrohet nga 87 pika, në të gjitha rajonet e Spanjës.^{65, 66}

Dy OSHC rome (Romeurope dhe La Voix des Roms) janë pjesë e bordit të **CNCDH-së në Francë** dhe u merret mendimi mbi aktivitetet që lidhen me romët dhe sintët (për shembull, gjatë hartimit dhe nxjerrjes së opinionëve).⁶⁷

Një OSHC rome greke (Ellan Passe), që ka degët e saj në të gjithë Greqinë, është ndër 42 anëtarët e seancës plenare të **Komisionit Kombëtar të Greqisë për të Drejtat e Njeriut (GNCHR)**.⁶⁸

63 Avokati i Popullit i Shqipërisë, përgjigje ndaj pyetësorit.

64 Testimi i situatës është një metodë për zbulimin e diskriminimit që krahason se si trajtohen individë të ndryshëm në situata të ngjashme. Ndjekja e çështjes në rrugë gjyqësore është dërgimi i një çështjeje në gjykatë për të kërkuar drejtësi për viktimat e diskriminimit/shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ndjekja gjyqësore strategjike e çështjeve është qasje ligjore e qëllimshme, ku çështja përzgjidhet jo vetëm për të ndihmuar një individ, por edhe për të sjellë ndryshime më të gjera ligjore ose politike, ku çështjet shërbejnë si precedent. Për më shumë informacion në lidhje me testimin e situatës shihni: *Të Provuarit e Rasteve të Diskriminimit – Roli i Testimit të Situatës*, Faqja Evropiane e Internetit për Integrimin, 27 mars 2007; Isabelle Rorive, *Vërtetimi i Rasteve të Diskriminimit, Roli i Testimit të Situatës*, Qendra për të Drejta të Barabarta, 2009; Përmbledhje e Trajnimit të EQUINET: Organet e Barazisë që përdorin Testimin e Situatës, EQUINET, Vilnius, 3-4 qershor 2024; EQUINET, *Përfshirja e Romëve dhe Shtegtarëve*, fq. 14 [anglisht].

65 Po aty.

66 Përgjigja nga Avokati i Popullit në Spanjë.

67 CNCDH-ja në Francë, përgjigje ndaj pyetësorit.

68 GNCHR-ja në Greqi, përgjigje ndaj pyetësorit.

3.3 Hartimi dhe miratimi i një sërë udhëzimesh dhe protokolleve të përbashkëta për parandalimin e shkeljes së të drejtave të njeriut të pakicave rome dhe sinti

Normat e barazisë kanë në fakt natyrë reaguese ndaj situatave, duke ofruar zgjidhje individuale për personat pasi ata kanë përjetuar diskriminim.⁶⁹ Ndaj, është e rëndësishme të shqyrtohet se si IKDNJ-të dhe IKB-të mund të ndihmojnë në parandalimin e diskriminimit pa prituri të ndodhë.

Kjo mund të arrihet pjesërisht përmes masave paraprake, siç janë hartimi i kodeve të punës ose udhëzuesve praktikë mbi mosdiskriminimin (dhe veçanërisht për çështjet e romëve dhe sintëve) dhe shpërndarja e tyre te zyrtarët shtetërorë.

Në të njëjtën kohë, duke parë dhe vështirësitë e hasura në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore të ndara sipas bazave të ndryshme, është thelbësore që të gjitha palët e interesuara të bien dakord mbi **metodat e përbashkëta të mbledhjes së të dhënave**. IKDNJ-të, dhe veçanërisht IKB-të, duhet t'u theksojnë të gjithë aktorëve rëndësishëm e të dhënave statistikore cilësore në luftën ndaj diskriminimit dhe vlerësimin e ndikimit të legjislacionit dhe politikave kundër diskriminimit. Ato, gjithashtu, duhet të japin rekomandime të qarta se si të përmirësohet mbledhja e të dhënave. Për këtë qëllim, disa IKB po bashkëpunojnë me institutet kombëtare të statistikave, ndërsa të tjera po shqyrtojnë mundësinë e **miratimit të udhëzuesit për mbledhjen e të dhënave të Nëngrupit për të Dhënat e Barazisë të Grupit të Nivelit të Lartë të BE-së për Mosdiskriminimin, Barazinë dhe Diversitetin**.⁷⁰

Në mënyrë të ngjashme, është e rëndësishme të gjenden rrugë për të vlerësuar ndikimin e IKDNJ-ve dhe IKB-ve, si dhe të aktiviteteve, masave dhe politikave të autoriteteve shtetërore mbi çështjet e romëve dhe sintëve. Kjo mund të përfshijë **hartimin dhe miratimin e treguesve të synuar** (sipas modelit të portofolit të treguesve të FRA-së, të hartuar në kuadrin e Kornizës Strategjike të BE-së për Romët⁷¹), që do të përdoren nga të gjithë aktorët që punojnë me çështjet e romëve dhe sintëve.

69 Komisioni Evropian, COM/2022/689 final, f. 18 [anglisht].

70 Komisioni Evropian, COM/2021/139 final, pjesa 2.2.2.1 [anglisht].

71 Komisioni Evropian, COM(2020) 620 final, Shtojca e Komunikimit nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: Një Bashkim Barazie: Korniza strategjike e BE-së për romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, Bashkimi Evropian, Bruksel, 7 tetor 2020; Komisioni Evropian, COM(2020) 620 final, Shtojca [anglisht].

Avokati i Popullit në Greqi ka hartuar dhe shpërndarë një manual⁷² dhe udhëzues mbi çështjet e mosdiskriminimit për nëpunësit civilë.⁷³ Ai ka hartuar dhe shpërndarë, gjithashtu, një udhëzues praktik mbi çështjet e romëve për autoritetet e qeverisjes vendore, duke u ofruar atyre rekomandime konkrete për trajtimin e çështjeve të ndryshme me të cilat përballen romët.⁷⁴

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi ka përgatitur materiale edukative dhe botime të përshtatura për grupe të ndryshme, si zyrtarët e qeverisjes vendore, oficerët e rendit publik, nëpunësit civilë dhe mësuesit.⁷⁵

Për të lehtësuar dhe nxitur respektimin e Ligjit për **Barazinë, Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut** në Britaninë e Madhe⁷⁶ ka hartuar dhe promovuar kode praktike mbi tema të ndryshme, si punësimi, ofrimi i shërbimeve dhe paga e barabartë. Këto kode japin shpjegime të hollësishme të dispozitave ligjore dhe mënyrën se si konceptet ligjore në Ligjin për Barazinë mund të zbatohen në situatat e përditshme, duke përfshirë gjuhë dhe shembuj të veçantë rreth ciganëve dhe shtegtarëve.⁷⁷

EQUINET-i ka nxjerrë një raport mbi mbledhjen dhe përdorimin nga organet e barazisë të të dhënave mbi ankesat,⁷⁸ duke identifikuar sfidat e përbashkëta dhe duke dhënë rekomandime për trajtimin e tyre. Gjithashtu, ai ka ngritur një Grup Pune për Kërkimin dhe Mbledhjen e të Dhënave, për të përmirësuar dhe koordinuar mbledhjen e të dhënave mes anëtarëve të tij.

72 Synήγορος του Πολίτη, Οδηγός Διαφορετικότητας για Δημοσίους Υπαλλήλους με Σκοπό την Καταπολέμηση των Διακρίσεων – Ποιόν έχω απέναντί μου, (Avokati i Popullit në Greqi, Manual mbi diversitetin për nëpunësit civilë për luftën kundër diskriminimit – Kush qëndron para meje?), Avokati i Popullit në Greqi, Athinë [greqisht].

73 Synήγορος του Πολίτη, Οδηγός Ίσης Μεταχείρισης – Εγχειρίδιο για Δημοσίους Υπαλλήλους – Ο Σεβασμός κάνει τη διαφορά (Udhëzues për të gjithë nëpunësit civilë mbi trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin - Respekti bën dallimin) [greqisht].

74 Synήγορος του Πολίτη, Πρακτικός Οδηγός για Δημοτικές Αρχές – Υπάρχουν σκηνίτες και κοινωνικά αποκλεισμένοι Τσιγγάνοι / Ρομά στο Δήμο μας – Τι μπορούμε να κάνουμε; (Avokati i Popullit në Greqi, Udhëzues Praktik për Bashkitë – Në bashkinë tonë ka ciganë/romë që banojnë në tenda dhe që janë të lënë mënjanë nga shoqëria - Çfarë mund të bëjmë?), Avokati i Popullit në Greqi, Athinë [greqisht].

75 Përgjigje nga Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi.

76 IKDNJ-ja e Anglisë, Skocisë dhe Uellsit në Mbretërinë e Bashkuar.

77 Akti i Barazisë 2010 Kodet e Praktikës, Komisioni i Barazisë dhe të Drejtave të Njeriut, 2019 [anglisht].

78 Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave mbi ankesat nga organet e barazisë, EQUINET, 2021 [anglisht].

3.4 Lufta efektive kundër “gjuhës së urrejtjes” ndaj romëve dhe sintëve

Është ritheksuar nevoja për të luftuar “gjuhën e urrejtjes” dhe stereotipet kundër romëve. Rekomandimi i Këshillit të Bashkimit Evropian për Romët u bën thirrje IKB-ve të marrin në konsideratë rastet e “gjuhës së urrejtjes” dhe të trajtojnë raportimin e pamjaftueshëm.⁷⁹ Komisioni Evropian ka propozuar që “gjuha e urrejtjes”, bashkë me krimin e urrejtjes, të përfshihen në listën e krimeve të BE-së, përkatësisht ato krime për të cilat Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian mund të miratojnë së bashku rregulla minimale.⁸⁰ Në mënyrë të ngjashme, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar një Rekomandim mbi “gjuhën e urrejtjes”, duke përcaktuar kategori të ndryshme të “gjuhës së urrejtjes” dhe duke propozuar një gamë të gjerë masash për trajtimin e saj.⁸¹

IKDNJ-të dhe IKB-të mund të kenë si rol parandalues, ashtu edhe reagues në luftën kundër “gjuhës së urrejtjes”. Në rastin më të mirë në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e gazetarëve dhe OSHC-të rome, ato mund të hartojnë **udhëzues mbi çështjet e romëve dhe sintëve, duke sjellë informacione thelbësore rreth komuniteteve të tyre, duke sjellë narrativa të kundërta⁸² qasje alternative**, si dhe duke çrrënjësuar perceptimet e gabuara e të zakonshme rreth romëve. Është thelbësore të bëhet një vlerësim i qartë i arsyeve të dështimit të politikave të ndryshme kombëtare për përmirësimin e situatës së romëve dhe sintëve, pasi shpesh publiku mendon se këto dështime vijnë si pasojë e mungesës së gatishmërisë së romëve dhe sintëve për t’u integruar në shoqëri.

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet, gjithashtu, të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese, të trajtojnë paragjykimet dhe stereotipet dhe të inkurajojnë narrativa të kundërta, duke zhvilluar fushata ndërgjegjësuese në rrjetet sociale dhe në platforma të tjera, ose duke organizuar kurse trajnimi mbi paragjykimet dhe stereotipet e pavetëdijshme për gazetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar.

79 Këshilli i Bashkimit Evropian, Rekomandimi 2021/C 93/01.

80 Komisioni Evropian, COM(2021) 777 final, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: Një Evropë më gjithëpërfshirëse dhe mbrojtëse: zgjerimi i gamës së krimeve në BE që përfshin gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, Bashkimi Evropian, Bruksel, 9 dhjetor 2021 [anglisht].

81 Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM/Rec (2022)16 Për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, Këshilli i Evropës, Strasburg, 20 maj 2022. [anglisht].

82 "Narrativa e kundërt është praktika e reagimit ndaj një fjalori, që duket i dëmshëm ose fytes. Mund të shfaqet në shumë forma, si kundërshtimi, demaskimi ose kritikimi i gjuhës së dëmshme, theksimi i pikëpamjeve alternative, dhënia e informacionit të saktë, dhe nxitja e empatisë dhe mirëkuptimit. Organizatat dhe studiuesit përdorin përkufizime të ndryshme të narrativës së kundërt", faqja e internetit "E ardhmja e Lirisë së Shprehjes", parë së fundi më 10 prill 2025 [anglisht].

Gjithashtu, IKDNJ-të dhe IKB-të mund të punojnë me gazetarët se si të dallojnë dhe parandalojnë “gjuhën e urrejtjes”, përmes **trajtimeve ose duke hartuar udhëzues mbi kufijtë e të drejtës së lirisë së shprehjes**, në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së ose të gjykatave vendore, si dhe standardet ndërkombëtare. IKDNJ-të dhe IKB-të mund të **ofrojnë edhe ndihmë ligjore të specializuar për organet vetërregulluese të gazetarëve, kur ato zbatojnë kodet e tyre të sjelljes** në rastet e procedurave disiplinore ndaj gazetarëve të përfshirë në “gjuhën e urrejtjes”.⁸³

IKDNJ-të dhe IKB-të mund të bashkëpunojnë dhe me policinë, prokurorinë ose njësitë e specializuara të krimeve të urrejtjes, për të mbështetur masat ndaj rasteve që përfshijnë krime të motivuara nga urrejtja, si dhe rastet e ‘gjuhës së urrejtjes’ që nxisin dhunë dhe krim, si dhe për të nxitur praktikën e dhënies së opinionëve këshillimore në ndihmë të hetimeve. Vetë IKDNJ-të dhe IKB-të duhet, gjithashtu, **t’u japin përparësi dhe të hetojnë rastet e ‘gjuhës së urrejtjes’ që nuk përbëjnë vepër penale**. Masat standarde (për shembull, gjambat administrative) mund të mos jenë të mjaftueshme për të ndaluar përsëritjen e rasteve të ‘gjuhës së urrejtjes’, ndaj IKDNJ-të dhe IKB-të duhet t’i hetojnë rastet dhe t’u bëjnë propozime ligjvënësve (për shembull, përmes një raporti të posaçëm) për miratimin e mekanizmave të rinj për zgjidhjen e çështjeve.

Rregulloret kundër diskriminimit mund të ndryshohen për të përfshirë masa edukuese të bazuara në parimin e drejtësisë restauruese, për shembull, duke urdhëruar palën përgjegjëse të marrë pjesë në seminare ndërgjegjësuese. Në rast se kuadri ligjor lejon, IKDNJ-të dhe IKB-të mund t’i **urdhërojnë autorët të publikojnë kërkesa publike për falje dhe/ose gjetjet e hetimeve mbi sjelljen diskriminuese**. Ato mund të veprojnë edhe si sisteme ‘paralajmërimi të hershëm’, duke theksuar shembuj të stereotipeve ose ‘gjuhës së urrejtjes’ ndaj romëve, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi standardet lidhur me ‘gjuhën e urrejtjes’.

83 Për më shumë informacion rreth romëve dhe sintëve dhe mediave të komunikimit masiv, shih [Raportin e 4-të Statusit të OSBE/ODIHR-it](#), fq. 34-37 [anglisht].

Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut i Britanisë së Madhe ka hartuar një paketë me materiale për mediat mbi romët shtegtarë në Skoci. Udhëzuesi përmban informacione të përgjithshme mbi historinë dhe situatën aktuale të romëve shtegtarë, duke theksuar çështjet kryesore sociale dhe të politikave me të cilat ata përballen, për të inkurajuar raportimin e balancuar nga gazetarët.⁸⁴

Komisioni për Barazinë i Irlandës së Veriut ka hartuar një deklaratë mbi pabarazinë në trajtimin e romëve shtegtarë në Irlandën e Veriut. Deklarata ofron një pasqyrë të vështirësive me të cilat përballen romët shtegtarë dhe grupet e tjera sociale të cënueshme në jetën e tyre të përditshme.⁸⁵

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Bullgarisë vendosi në favor të një ankese se një artikull lajmesh cenonte dinjitetin e etnisë rome, nxiste një imazh mjaft negativ të romëve si kriminelë të organizuar, sugjeronte se ata ishin keqpërbës dhe hajdutë, dhe krijonte një qëndrim publik përbuzës dhe neveritës ndaj romëve, duke krijuar kështu një mjedis poshtërues, degradues dhe abuziv për aplikuesin. Komisioni arriti në përfundimin se të pandehurit, së bashku dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nxitën diskriminimin, i cili përbënte një inkurajim për diskriminim. Ai vendosi gjobë dhe e urdhëroi autorin të heqë dorë nga kryerja e veprimeve të ngjashme në të ardhmen. Po ashtu urdhëroi pronarin e medias të merrte masa për të parandaluar botimin e artikujve të tillë në të ardhmen.⁸⁶

Këshilli për Eliminimin e Diskriminimit Racor ose Etnik në Spanjë botoi një udhëzues mbi përfaqësimin e romëve në media, me rekomandime për profesionistët e medias, kompanitë e komunikimit, dhe autoritetet publike.⁸⁷

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi ka një sistem ‘paralajmërimi të hershëm’ (i cili ndonjëherë mund të përfshijë ‘ekspozimin dhe turpërimin’), me anë të të cilit informon me shpejtësi publikun mbi rastet veçanërisht serioze të diskriminimit dhe rastet e fyerjes ose ‘gjuhës së urrejtjes’ kundër romëve nga individë privatë ose zyrtarë shtetërorë. Kjo jo vetëm që rrit ndërgjegjësimin publik në lidhje me ‘gjuhën e urrejtjes’ dhe standardet, por gjithashtu shpesh i inkurajon njerëzit që përfshihen në sjellje me stereotipe/‘gjuhë urrejtjeje’ të tërheqin deklaratat e tyre dhe të kërkojnë falje publike.⁸⁸ Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar gjithashtu me median, duke organizuar

84 Romët shtegtarë në Skoci – material për median, Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut, Skoci, 2013 [anglisht].

85 Deklaratë mbi Pabarazitë Kryesore në Irlandën e Veriut, Komisioni për Barazinë i Irlandës së Veriut, tetor 2007 [anglisht].

86 EQUINET, Përfshirja e Romëve dhe Shtegtarëve, f. 20 [anglisht].

87 Po aty.

88 Kështu, më 7 shkurt 2024, Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi nxori një paralajmërim mbi një sërë komentesh stereotipike kundër romëve, të përdorura nga një deputet për të përshkruar ngjarjet që ndodhën në Parlamentin e Serbisë, duke theksuar nevojën që zyrtarët dhe figurat publike të jenë më të kujdesshëm në deklaratat e tyre dhe duke i bërë thirrje deputetit të kërkojë falje [anglisht].

trajtime përgazetarët, si dhe ka botuar manuale mbi raportimin jodiskriminues. Për më tepër, ajo organizon konkurs vjetor me dhënie çmimesh për rastet që nxisin tolerancën dhe barazinë.

Në raportin e tij të vitit 2018, 'Zgjerimi i Agjendës: Organet e Barazisë që trajtojnë Gjuhën e Urrejtjes',⁸⁹ **EQUINET-i** thekson rolin që IKB-të mund të luajnë në luftën kundër 'gjuhës së urrejtjes', duke u bërë atyre thirrje që të miratojnë strategji gjithëpërfshirëse për këtë qëllim dhe të nxisin narrativa që kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes.

3.5 Forcimi i mbrojtjes ndaj diskriminimit, retorikës kundër romëve dhe sintëve, dhe 'gjuhës së urrejtjes' ndaj tyre në internet

Përveç masave të përmendura më sipër, IKDNJ-të dhe IKB-të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën ndaj akteve të diskriminimit kundër romëve dhe sintëve dhe 'gjuhës së urrejtjes' në internet, një problem me përmasa shqetësuese.

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet t'i inkurajojnë të gjithë aktorët e interesuar (si, ofruesit e internetit, platformat e rrjeteve sociale dhe ndërmjetësit online) që të miratojnë kode të përshtatshme sjelljeje, në përputhje me **Kodin e Sjelljes të Komisionit Evropian të vitit 2016 për Luftën kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet** dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të Nenit 35(3) të Aktit për Shërbimet Digjitale (DSA), që hyri në fuqi në shkurt të vitit 2024.⁹⁰

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet t'i ndihmojnë aktorët e interesuar në hartimin dhe zbatimin e masave, me vëmendje të veçantë në zhvillimin e procedurave të efektshme për raportimin e "gjuhës së urrejtjes".

Duhet gjithashtu të shqyrtohet mundësia që IKDNJ-të dhe IKB-të të veprojnë si "verifikues faktesh" për çështjet e të drejtave të njeriut. Portalet tregtare të lajmeve duhet të detyrohen të monitorojnë në mënyrë të rreptë përmbajtjen

89 Zgjerimi i Agjendës: Organet e Barazisë që trajtojnë Gjuhën e Urrejtjes, EQUINET, 2018 [anglisht].

90 Rregullorja (BE) 2022/2065 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 tetor 2022, mbi një Treg të Vetëm për Shërbimet Digjitale, që ndryshon Direktivën 2000/31/KE (Akti për Shërbimet Digjitale, DSA). Për një prezantim të shkurtër të DSA-së, shihni Çfarë është Akti për Shërbimet Digjitale dhe çfarë do të thotë ai për monitorimin dhe kundërpërgjigjen ndaj gjuhës së urrejtjes? Sfidat kryesore në zbatimin e DSA-së, Facing Facts Network (Rrjeti "Përballja me Faktet"), 2024 [anglisht].

e palëve të treta për “gjuhë urrejtjeje” dhe të ndërmarrin hapat e duhura, detyrim që tashmë e kanë për komentet shpifëse ose nxitjet për dhunë.⁹¹ Për më tepër, IKDNJ-të dhe IKB-të, së bashku me organet vetërregulluese të gazetarëve, mund të shqyrtojnë mundësinë e organizimit **të trajnimeve për profesionistët e medias dhe përfaqësuesit e OSHC-ve, mbi mënyrën se si të dallojnë dhe raportojnë “gjuhën e urrejtjes”**, veçanërisht duke pasur parasysh përdorimin në rritje të gjuhës së koduar në internet nga grupe më ekstreme. IKDNJ-të dhe IKB-të mund të bashkëpunojnë me mediat dhe/ose OSHC-të për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rreziqet e “gjuhës së urrejtjes”, duke ndihmuar në heqjen e dyshimeve nëse “gjuha e urrejtjes” është një formë shprehjeje e mbrojtur nga e drejta për lirinë e fjalës, dhe për të nxitur shembuj që kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes, si dhe narrativa alternative në lidhje me romët dhe sintët.

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet **të monitorojnë përdorimin e formave më të rënda të “gjuhës së urrejtjes” dhe t’i raportojnë ato te autoritetet e hetimit**, veçanërisht nëse janë kryer nga njerëz ose subjekte me ndikim, gjë që mund t’i shkurajojë personat e prekur të bëjnë ankim.

Qendra Ndërfederale për Mundësi të Barabarta dhe Kundërshtimin e Racizmit në Belgjikë (UNIA) ka testuar ndërmjetësimin si një mënyrë për të trajtuar ‘gjuhën e urrejtjes’ në internet. Ajo përpiket të kontaktojë autorin e mesazheve të urrejtjes, drejtpërdrejt kur është e mundur, duke pasur parasysh profilin e autorit. Ajo gjithashtu kontribuon në monitorimin e Kodit të Sjelljes së BE-së dhe ka statusin e ‘sinjalizuesit të besuar’ në lidhje me platformat e rrjeteve sociale që kanë nënshkruar Kodin. Megjithatë, ajo njëkohësisht raporton tek autoritetet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, format veçanërisht të rënda të ‘gjuhës së urrejtjes’, ndonjëherë me iniciativën e saj.⁹²

91 *Delfi AS kundër Estonisë* [GC], nr. 64569/09, 16 qershor 2015 [anglisht].

92 *Zgjerimi i Agjendës: Organet e Barazisë që trajtojnë Gjuhën e Urrëjtjes*, EQUINET, 2018, fq. 12 [anglisht].

PJESA 4

MBROJTJA LIGJORE E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE TË DISKRIMINIMIT ROMË DHE SINTI

4.1 Nisja e proceseve ose ndërhyrja në rastet e diskriminimit të romëve dhe sintëve pranë gjykatave vendore dhe ndërkombëtare

Duke njohur rëndësinë e ngritjes së padive në luftën kundër diskriminimit, Këshilli i Bashkimit Evropian u ka bërë thirrje IKB-ve që jo vetëm të ndjekin raste të tilla, por edhe **të ngrenë padi strategjike** në këtë fushë.⁹³ Një arsye tjetër pse IKDNJ-të, kur është e zbatueshme, dhe IKB-të duhet të ngrenë padi në mënyrë më aktive është numri relativisht i ulët i çështjeve të diskriminimit ndaj romëve dhe sintëve regjistruar në gjykatat vendore dhe ndërkombëtare (krahasuar me ato që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut).⁹⁴ Në të kaluarën, donatorë privatë kanë mbështetur OSHC-të në ngritjen e padive strategjike për romët dhe sintët. Megjithatë, ndryshimet e objektivave dhe prioritetëve të tyre të financimit bëjnë që kjo mbështetje të mos jetë gjithmonë e mundur. Për më tepër, marrja e drejtimit nga OSHC-të për ndjekjen e padive në fushën e mosdiskriminimit i jep publikut të gjerë përshtypjen se këto çështje janë të rëndësishme vetëm për një pakicë dhe jo për të gjithë shoqërinë. Ndaj, IKDNJ-të, kur është e zbatueshme, dhe IKB-të duhet të jenë strategjikisht më aktive në lidhje me ndjekjen e çështjeve në rrugë gjyqësore. Nëse legjislacioni vendas nuk e lejon përfshirjen e tyre në procese gjyqësore ose mbrojtjen ligjore, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të kërkojnë aktivisht që mandati i tyre të zgjerohet, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira, duke nxjerrë raporte të posaçme ose opinione këshillimore, dhe me mbështetjen e OSHC-ve.

93 Këshilli i Bashkimit Evropian, Rekomandimi 2021/C 93/01, Rekomandimi 14(a) [anglisht].

94 Komisioni Evropian, Rrjeti Evropian i ekspertëve ligjorë për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, Romët dhe zbatimi i legjislacionit për mosdiskriminimin, Bashkimi Evropian, 2017, fq. 8; Kombet e Bashkuara, A/HRC/29/24, Raporti i Raportueses Speciale për Çështjet e Pakicave, Rita Izsák, Studim gjithëpërfshirës mbi situatën e të drejtave të njeriut të romëve në mbarë botën, me vëmendje të veçantë ndaj fenomenit të anticiganizmit, 11 maj 2015, pika 79 [anglisht].

Një strategji gjithëpërfshirëse mbi çështjet gjyqësore duhet të parashikojë forma të ndryshme të hapave ligjorë. Sipas Direktivave të reja të BE-së që përcaktojnë standarde detyruese për Organet e Barazisë,⁹⁵ IKB-të duhet të kenë të drejtë të marrin pjesë në proceset gjyqësore për çështje të së drejtës civile dhe administrative që kanë të bëjnë me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.⁹⁶ Për më tepër, e drejta e IKB-ve për të marrë pjesë në proceset gjyqësore “përfshin të drejtën për të paraqitur parashtresa para gjykatës”, si dhe përfshin “të paktën një nga kompetencat e mëposhtme: (a) të drejtën për të inicuar procese gjyqësore në emër të një ose disa viktimave; (b) të drejtën për të marrë pjesë në proceset gjyqësore në mbështetje të një ose disa viktimave; ose (c) të drejtën për t’i iniciuar vetë proceset gjyqësore për mbrojtjen e interesit publik”.⁹⁷ Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, e drejta e organit të barazisë për të marrë pjesë në proceset gjyqësore “përfshin të drejtën për të marrë pjesë si palë në procedurat për ekzekutimin ose kontrollin gjyqësor të vendimeve detyruese, kur organet e barazisë janë të autorizuar të marrin vendime të tilla (...)”.⁹⁸

Përveç rrugës më tradicionale të nxjerrjes së opinionëve, të cilat mund të jenë ose jo ligjrisht të detyrueshme, si dhe të ndërmarrjes së hapave ligjorë të sipërpërmendur, IKDNU-të dhe IKB-të duhet gjithashtu të kërkojnë të kenë kompetencë për të inicuar procedura *proprio motu* në gjykatat vendore,⁹⁹ edhe në mungesë të një viktime të caktuar. Një proces i tillë gjyqësor ka një sërë përparësish. Së pari, është padyshim më e lehtë për IKDNU-të dhe IKB-të që të ngrenë padi pa pasur shqetësim hakmarrjet ndaj individëve ankues dhe nevojën për t’u ofruar atyre mbrojtje nga viktimizimi. Së dyti, duke pasur parasysh gatishmërinë e GJEDNJ-së për të marrë në konsideratë që aplikuesit të mos e kenë detyrimin të shterojnë mjetet juridike vendase, nëse për të njëjtën çështje është bërë ankim para IKB-së nga një kërkues tjetër,¹⁰⁰ padia *proprio motu* nga IKB-të dhe IKDNU-të do t’i lejojë në fakt aplikuesit e mundshëm në GJEDNJ që të shmangin ngritjen e padive në nivel vendor dhe t’i drejtohen drejtpërdrejt GJEDNJ-së, zhvillim me shumë dobi ky për shoqërinë civile rome dhe sinti dhe aktivistët e të drejtave të njeriut, sa i përket kohës dhe burimeve të tyre.

95 [Direktiva e Këshillit \(BE\) 2024/1499](#) e 7 majit 2024 dhe [Direktiva \(BE\) 2024/1500](#) e 14 majit 2024 [anglisht].

96 Po aty, Neni 10.

97 Po aty.

98 Po aty.

99 Duhet theksuar se dy çështje themelore mbi diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe gjuhën e urrejtjes, përkatësisht në GJDBE dhe GJEDNJ, e kanë zanafillën në raste të filluara nga organet kombëtare të barazisë në Belgjikë: GJDBE, [Rasti C-54/07](#) Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v Firma Feryn NV, 10 korrik 2008, [anglisht] dhe Féret kundër Belgjikës, Nr. [15615/07](#), 16 korrik 2009 [frëngjisht].

100 [X dhe të tjerët kundër Shqipërisë](#), Nr. [73548/17](#) dhe [45521/19](#), 31 maj 2022, pika 64 [anglisht].

Së fundi, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të shqyrtojnë edhe forma të tjera të përfaqësimit ligjor, si përmes bërjes së parashtresave si person i tretë në çështje me interes për të drejtat e njeriut, që janë ende në shqyrtim nga gjykatat vendore ose ndërkombëtare.

Mbrojtësi i të Drejtave në Francë solli parashtresa si person i tretë në një çështje në GJEDNJ,¹⁰¹ që kishte të bënte me dëbimin me forcë të emigrantëve rumunë romë nga një copë tokë që kishin zaptuar. Parashtresa u përqendrua në faktin se procedurat vendase nuk kishin qenë të efektshme për të kundërshtuar dëbimin me forcë, kish munguar strehimi në rast emergjence, dhe nuk ishin respektuar parimet mbi dëbimet me forcë që burojnë nga praktika e GJEDNJ-së. Gjatë procesit gjyqësor vendas, institucioni kishte bërë të njëjtat parashtresa para gjyqtarit që shqyrtoi kërkesën e aplikuesve për masa të përkohshme. Kohët e fundit, institucioni solli parashtresa si palë e tretë edhe në një çështje kundër Spanjës mbi profilizimin racor, që nuk kishte të bënte me romët dhe sintët,¹⁰² por është temë me rëndësi të veçantë edhe për ta. Ai gjithashtu ndjek praktikën sipas së cilës, pasi identifikon një çështje komplekse ligjore që mund të çojë në shumë raste, harton dhe publikon një vendim kuadër ku parashtron argumentet e tij. Ky vendim me autoritet të lartë mund të paraqitet më pas nga paditësit në proceset e tyre, pa qenë nevoja që institucioni të marrë pjesë në secilën çështje.¹⁰³

Në një rast që lidhej me diskriminimin ndaj një të riu rom sa i përket mundësisë për punësim, **Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor** kritikoi mosmarrjen në konsideratë nga gjykatat vendase të opinionit këshillimor të Këshillit të Moldavisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Diskriminimit dhe Sigurimin e Barazisë.¹⁰⁴

Në dy raste që kishin të bënin me veçimin e romëve në shkollë,¹⁰⁵ **GJEDNJ-ja** mori parasysh gjetjet e IKB-ve (Komisioneri i Shqipërisë për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioni i Maqedonisë së Veriut për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi). Për më tepër, në udhëzimet e saj në kuadër të Nenit 46 të Konventës Evropiane për masat e përgjithshme që qeveritë e paditura duhet të zbatojnë, GJEDNJ-ja theksoi se ato duhet të zbatojnë rekomandimet e bëra, ndër të tjera, dhe nga IKB-të përkatëse.

101 *Hirtu dhe të tjerë kundër Francës*, Nr. 24720/13, 14 maj 2020 [frëngjisht].

102 *Muhammad kundër Spanjës*, Nr. 34085/17, 18 tetor 2022 [anglisht].

103 Sophie Latraverse, *Raport i Shpejtë: Francë, Mbrojtja e të drejtës së viktimës për të pasur qasje në provat në rastet e diskriminimit*, Rrjeti Evropian i ekspertëve ligjorë të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, 12 dhjetor 2022 [frëngjisht].

104 CERD, *Komunikatë Nr. 60/2016*, Zapescu kundër Moldavisë, 31 maj 2021.

105 X dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Nr. 73548/17 dhe 45521/19, dhe Elmazova dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut, Nr. 11811/20 dhe 13550/20, 13 dhjetor 2022 [anglisht].

EQUINET, së bashku me Qendrën Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të Sllovakisë, kohët e fundit sollën një parashtresë të përbashkët si palë e tretë para GJEDNJ-së mbi një çështje që lidhej me veçimin e romëve në shkolla. Parashtresa bën një përmbledhje të gjetjeve të organeve ndërkombëtare, të praktikës gjyqësore vendase dhe ndërkombëtare, si dhe informacion mbi praktikatat e vendeve të ndryshme.¹⁰⁶

4.2 Mbështetja për zbatimin efektiv të vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore

IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të përfshihen aktivisht në zbatimin e vendimeve gjyqësore, si në nivel vendor, ashtu edhe ndërkombëtar. Vonesa dhe moszbatimi i vendimeve të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare¹⁰⁷, përfshirë ato të GJEDNJ-së, mund të kenë një ndikim të rëndë mbi mbrojtjen e të drejtave të romëve dhe sintëve dhe, më gjerë, mbi mjedisin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Ndaj, është thelbësore që IKDNJ-të dhe IKB-të të angazhohen në procesin e ekzekutimit dhe të mbështesin zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore, veçanërisht për çështjet që lidhen me format e ndryshme të diskriminimit ndaj romëve dhe sintëve.

Ekzistojnë tre hapa kryesorë për arritjen e kësaj. Së pari, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të analizojnë vendimin dhe të identifikojnë masat që duhen marrë për zbatimin e tij, si ndryshimet në legjislacion, politika ose praktikë, dhe këto gjetje duhen t'u komunikohen autoriteteve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit. Në mënyrë ideale, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të përfshihen drejtpërdrejt në ekzekutimin e vendimit.

106 *Organet e barazisë për arsimin gjithëpërfshirës: ndërhyrja e palëve të treta në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, EQUINET, 28 mars 2024 [anglisht].

107 Për shembull, në vitin 2022, IKDNJ-të dhe IKB-të nga Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Finlanda, Britania e Madhe, Greqia, Kosova, Irlanda e Veriut dhe Polonia raportuan vonesa dhe moszbatim të vendimeve të GJEDNJ-së, *Çështje Strukturore të të Drejtave të Njeriut*, ENNHRI, 2022 [anglisht].

Pas vendimit të GJEDNJ-së për çështjen *X dhe të tjerët kundër Shqipërisë*,¹⁰⁸ çështje që lidhej me veçimin e romëve në shkolla, **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** iu kërkuar mendim për hartimin e planit të veprimit për ekzekutimin e vendimit.¹⁰⁹ (Kërkesa e Komisionerit për të ndaluar veçimin në shkollën e aplikuesit nuk u zbatua nga autoritetet vendore, ndaj u paraqit kërkesë pranë GJEDNJ-së, e cila më pas mbështeti vendimin e Komisionerit.)

Së dyti, nëse autoritetet nuk e zbatojnë plotësisht vendimin, IKDNU-të dhe IKB-të duhet të angazhohen në mënyrë më të qëllimshme me autoritete dhe aktorë të ndryshëm, pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, shoqërinë civile ose organe të tjera të pavarura shtetërore. Ky angazhim mund të marrë forma të ndryshme, sipas kompetencave të ndryshme të IKDNU-ve dhe IKB-ve, të tilla si këshillimi, monitorimi, hetimi dhe raportimi, ose trajtimi i ankesave individuale.¹¹⁰ IKDNU-të dhe IKB-të mund të përqendrohen gjithashtu në aktivitete ndërgjegjësuëse dhe edukuese (si, punë kërkimore shtesë, takime pune, fushata në media dhe në internet) për të arritur një të kuptuar më të mirë të shkeljeve të identifikuara në vendimin e GJEDNJ-së dhe të masave të nevojshme për zbatimin e saj.¹¹¹

Nëse këto përpjekje nuk sigurojnë dot zbatimin e vendimit, në nivel vendor IKDNU-të dhe IKB-të mund të konsiderojnë fillimin e procedurave ligjore ose të vepronë si *amicus curiae* (mik i gjykatës) për çështje të ngjashme, ku të drejtat e individëve vazhdojnë të shkelen për shkak të moszbatimit të plotë të vendimeve të GJEDNJ-së. Në nivel ndërkombëtar, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së. IKDNU-të dhe IKB-të mund t'i paraqesin një komunikim Komitetit të Ministrave sipas Rregullit 9 të Rregullores së Komitetit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve dhe të kushteve të zgjidhjeve miqësore.¹¹² Sipas

108 *X dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Nr. 73548/17 dhe 45521/19 [anglisht].

109 Republika e Shqipërisë, *Plani Veprimi – Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, kërkesat Nr. 73548/17 dhe 45521/19 "X dhe të tjerët kundër Shqipërisë", 30 maj 2023, fq. 3 [anglisht].

110 Për udhëzime të mëtejshme mbi hapat konkretë që IKDNU-të dhe IKB-të mund të ndërmarrin kur angazhohen me aktorët e sipërpërmendur, shihni *Udhëzimin për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut për të mbështetur zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, ENNHRI, 2016, fq. 4-7 [anglisht].

111 Për të mësuar më shumë mbi mënyrën e organizimit të një fushate komunikimi, ju lutemi referojuni burimeve të mëposhtme të FreedomLab: *Përkrahja dhe Komunikimi mbi të Drejtat e Njeriut, dhe Aftësitë dhe Mjetet e Komunikimit për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut* [anglisht].

112 Komiteti i Ministrave, *Rregullorja e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve dhe të kushteve të zgjidhjeve miqësore*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 10 maj 2006 [anglisht].

Rregullit 9(2), Komiteti i Ministrave ka të drejtë të shqyrtojë çdo komunikim nga institucionet kombëtare për përkrahjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas Nenit 46(2) të Konventës, që prekin shtetin e tyre.^{113, 114}

Të dyja llojet e përpjekjeve, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, plotësojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën. Puna e IKDNJ-ve dhe IKB-ve në nivel vendor (për shembull, përmes paraqitjes së një parashtrese amicus curiae) mund të ndikojë në nivel ndërkombëtar dhe anasjelltas. Rezultatet në nivel ndërkombëtar (për shembull, një vendim i GJEDNJ-së për një çështje të caktuar) mund të përdoren për të fuqizuar nismat vendore (duke përdorur parimet e vendimit të GJEDNJ-së në procese të tjera gjyqësore në vend).

Në vitin 2007, **Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së** dha vendim për një çështje historike, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*.¹¹⁵ Gjykata vendosi që vendosja joproporcionale e fëmijëve romë në të ashtuquajturat “shkolla speciale”, së bashku me fëmijët me aftësi të kufizuara, përbënte diskriminim të paligjshëm. Qeveria çeke u urdhërua të ndalonte shkeljen dhe të ofronte zgjidhje për pasojat e saj dëmtoese. Pavarësisht planeve të veprimit dhe strategjive të ndryshme të nxjerra nga qeveria çeke, vendimi ende nuk është ekzekutuar plotësisht.

Përgjatë viteve, **Mbrojtësi Publik i të Drejtave i Republikës Çeke** organizoi aktivitete të ndryshme për të nxitur zbatimin e këtij vendimi historik. Ai monitoroi rregullisht zbatimin e tij¹¹⁶ dhe nxori rekomandime të veçanta,¹¹⁷ duke i këshilluar autoritetet shtetërore të siguronin zbatimin e plotë të

113 [Seri seminaresh online](#), Zbatimi Efektiv i Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ENNHRI, 2020 [anglisht].

114 Për më shumë informacion mbi paraqitjen e komunikimeve në Komitetin e Ministrave sipas Rregullit 9, shihni, [Shënim informues](#) Institutacionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut: Komunikime për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, ENNHRI, 2017, ose Departamentin për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, [Komunikime nga IKDNJ-të/OSHC-të](#), Këshilli i Evropës [anglisht].

115 D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC], Nr. 57325/00, 13 nëntor 2007 [anglisht].

116 Në vitet 2011-2012, Zyra e Mbrojtësit Publik të të Drejtave kreu një hulumtim të përqendruar në nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve romë në “shkollat e veçanta” që nga dalja e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen D.H. dhe të tjerë kundër Republikës Çeke. Shih Veřejný ochránce práv, [Výzkum potvrdil nepřímou diskriminaci romských žáků](#), (Mbrojtësi Publik i të Drejtave i Republikës Çeke: Hulumtimi konfirmoi se kishte diskriminim indirekt të nxënësve romë), Brno, 2012 [çekisht]. Në vitet në vijim, Zyra e Mbrojtësit Publik vazhdoi punën monitoruese dhe nxori disa raporte me rekomandime të veçanta. Shihni, Mbrojtësi Publik i të Drejtave, [Zbatimi i të Drejtës për Trajtim të Barabartë dhe Mbrojtje nga Diskriminimi](#), Brno, 2023 [anglisht].

117 Veřejný ochránce práv, [Doporučení veřejné ochránčyně práv ke společnému vzdělávání romských a neromských dětí](#), (Mbrojtësi Publik i të Drejtave i Republikës Çeke: Rekomandim i Mbrojtësit Publik të të Drejtave për edukimin e përbashkët të fëmijëve romë dhe joromë), Brno, 2017 [çekisht].

vendimit. Ai gjithashtu organizoi një seminar të dedikuar ngritjes së padive strategjike në rastet e diskriminimit¹¹⁸, si dhe aktivitete të tjera për ndërtimin e kapaciteteve¹¹⁹ dhe rritjen e ndërgjegjësimit, si për shembull një fushatë në internet me video,¹²⁰ dhe dorëzoi dy komunikime pranë Komitetit të Ministrave, sipas Rregullit 9.

Po kështu, **Zyra e Avokatit të Popullit të Sllovenisë** ka përvojë të gjatë në monitorimin, këshillimin dhe ofrimin e opinioneve dhe rekomandimeve mbi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, për shembull, përmes raportit të saj vjetor. Për shkak të numrit të lartë të vendimeve të pazbatuara,¹²¹ në vitin 2014, Parlamenti Slloven miratoi ndryshime në Ligjin për Administratën Publike, duke e ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë me detyrën për të udhëhequr zbatimin e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare. Në vitin 2015, u krijua një Grup Pune Ndërqeveritar (GPN) për koordinimin e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ-së. GPN-ja ka në përbërje dy përfaqësues nga Zyra e Avokatit të Popullit, çka fuqizon gjithashtu në mënyrë formale edhe rolin e Zyrës së Avokatit të Popullit në procesin e zbatimit. Si rezultat i këtyre reformave strukturore dhe vullnetit politik, numri i vendimeve të pazbatuara ra ndjeshëm, nga 309 në vitin 2015 në tetë në vitin 2020.¹²²

4.3 Ngritja e shërbimeve mbështetëse për viktimat e diskriminimit dhe sigurimi i qasjes në to për anëtarët e komuniteteve romë dhe sinti

Pavarësisht punës së çmuar të IKDNJ-ve dhe IKB-ve, kërkimet tregojnë se vetëm rreth gjysma e komunitetit rom është në dijeni se ka ndonjë organ barazie në vendin e tyre në 12 shtete anëtare të BE-së. Për më tepër, numri i ankesave të paraqitura në këto organe vazhdon të jetë jashtëzakonisht i ulët.¹²³ Kjo tregon se, në rastin më të mirë, romët dhe sintët mund të dinë se mund të ankohen në një IKB, por nuk dinë se cilat janë të drejtat e tyre, nëse këto të

118 Veřejný ochránce práv, *Seminář - Strategická litigace a boj proti diskriminaci* (Mbrojtësi Publik i të Drejtave i Republikës Çeke: Seminar – Ngritja e padive strategjike dhe lufta kundër diskriminimit), Brno, 13 nëntor 2017 [çekisht].

119 Për informacion në lidhje me seminare, tryeza të rumbullakëta ose aktivitete të tjera mbi diskriminimin dhe trajtimin e barabartë, vizitoni faqen e aktiviteteve [çekisht].

120 Shihni edhe [video](#)n [çekisht].

121 Deri në fund të vitit 2015, Sllovenia kishte 309 vendime të GJEDNJ-së të pazbatuara. Për më shumë: [të dhëna](#) (sllovenisht).

122 Për më shumë, shihni [Si ka arritur Sllovenia të ulë numrin e vendimeve të pazbatuara duke krijuar një strukturë të fortë në nivel vendor?](#), Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Sllovenisë, parë së fundi më 10 prill 2025 [anglisht].

123 [Romët në 10 vende evropiane – Rezultatet kryesore, Sondazhi i Romëve 2021](#), Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), Vjenë, 2022, fq. 31 [anglisht].

drejta janë shkelur, dhe as se si të veprojnë në këto raste. Kërkimet e kryera për këtë botim vërtetojnë se, pothuajse të gjitha IKDNJ-të/IKB-të e anketuara pranuan se numri i ankesave që marrin nga romët dhe sintët është i ulët në mënyrë joproporcionale, duke pasur parasysh problemet me të cilat përballen. Të anketuarit mendojnë se arsyet për këtë raportim të ulët janë strukturore, kryesisht për shkak të analfabetizmit të romët dhe sintët, faktit që ata duhet të shpenzojnë kohë dhe para për të përballuar nevoja më urgjente, si dhe kapaciteteve të kufizuara të OSHC-ve të komuniteteve romë dhe sinti.

Që romët dhe sintët t'u drejtohen IKDNJ-ve dhe IKB-ve, ata së pari duhet t'i njohin të drejtat e tyre. Ndaj, IKDNJ-të dhe IKB-të, bashkë me aktorët e tjerë dhe OSHC-të romë dhe sinti, duhet të gjejnë mënyra për t'i informuar romët mbi të drejtat e tyre, përfshirë **përgatitjen e variantit të kartës së të drejtave në gjuhën romë**. Ato duhet të përgatisin **materiale të përshtatura dhe miqësore për përdoruesit ose video të shkurtra, që shpjegojnë, në gjuhën kombëtare dhe në dialektin vendas rom, konceptet kryesore të të drejtave të njeriut dhe dispozitat ligjore, në një mënyrë të qartë dhe të thjeshtë**.

Në të njëjtën kohë, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet **të bëhen më të arritshme**, për shembull, duke bërë të mundur që njerëzit të mund të paraqesin ankesa përmes internetit ose përmes videokonferencave, duke hapur zyra në pjesë të tjera të vendit, duke pasur orare pune të përshtatura me nevojat, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin mbi punën e tyre tek popullata e përgjithshme, dhe veçanërisht tek romët dhe sintët. IKDNJ-të dhe IKB-të mund të bashkëpunojnë ose të krijojnë partneritete me OSHC-të e komunitetit rom dhe sinti, me rrjetet e ndërmjetësve shëndetësorë romë ose ndërmjetësve të arsimit romë, për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta ndërgjegjësimi dhe për të vizituar komunitetet e izoluara romë dhe sinti. Ato gjithashtu mund t'i trajnojnë OSHC-të romë dhe sinti që të bëhen pika referimi për romët dhe sintët që duan të paraqesin ankesa.

Kur nevojitet mbështetje më e specializuar për rastet e diskriminimit, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të kenë kompetencë për t'i referuar viktimat te shërbimet e duhura mbështetëse, e ngjashme me kompetencat e autoriteteve të përcaktuara në Direktivën 2012/29/BE.¹²⁴

124 Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, [Direktiva 2012/29/BE](#) e 25 tetorit 2012, që përcakton standardet minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA, Bashkimi Evropian, Bruksel, 14 nëntor 2012 [anglisht].

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Bullgarisë ka përfaqësues rajonale në 24 nga 28 rajonet e Bullgarisë. Ata i ofrojnë popullatës këshilla dhe informacione se si të paraqesin ankesa për diskriminim pranë Komisionit. Gjithashtu, ata i japin Komisionit informacione të rëndësishme mbi situatën në terren.¹²⁵

Mbrojtësi Publik i të Drejtave të Republikës Çeke ka hartuar fletëpalosje informuese në gjuhën rome për prindërit romë mbi regjistrimin në shkollën fillore dhe parandalimin e diskriminimit, një seri videosh në YouTube mbi arsimimin e fëmijëve romë.¹²⁶ dhe një seri shkrimesh në Facebook me titull “Romë, Mësoni të Mbroni Vetën nga Diskriminimi!”, që shpjegojnë se si të dallojnë diskriminimin dhe si të mbrohen prej tij.¹²⁷

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi ka botuar në gjuhën rome një udhëzues mbi identifikimin dhe raportimin e diskriminimit.¹²⁸

Përveç pranimit të ankesave përmes postës elektronike, **Avokati i Popullit në Spanjë** ka zhvilluar një sërë mjetesh, përfshirë një [pyetësor në internet](#), për të mbështetur paraqitjen e ankesave për diskriminim.¹²⁹

4.4 Miratimi i protokolleve për kryerjen e monitorimit strategjik (testimi i situatës) të qasjes dhe pjesëmarrjes së romëve dhe sintëve në shërbimet publike dhe private

Testimi i situatës është i rëndësishëm, si për të vërtetuar diskriminimin e drejtpërdrejtë në një rast të caktuar¹³⁰, ashtu edhe si një tregues i përhapjes së diskriminimit në fusha të ndryshme të jetës së përditshme. Ai mund të jetë një mjet i vlefshëm për hartimin e strategjive kundër diskriminimit të bazuar në prova,¹³¹ por duket se pak IKDNJ dhe IKB e përdorin atë. Kjo mund të vijë për shkak të mungesës së burimeve ose të ndalimit nga ligji vendas për kryerjen

125 Përgjigja nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Bullgarisë.

126 EQUINET, *Përfshirja e Romëve dhe Shtegtarëve*, fq. 16 [anglisht].

127 Veřejný ochránce práv, *Romové, pojďte se naučit bránit diskriminaci!* (Mbrojtësi Publik i të Drejtave të Republikës Çeke: Romë, Mësoni të Mbroni Vetën Kundër Diskriminimit!), Brno, maj 2024.

128 Po atya, fq. 14.

129 Përgjigja nga Avokati i Popullit në Spanjë.

130 Isabelle Rorive, *Vërtetimi i Rasteve të Diskriminimit: Roli i Testimit të Situatës*, Qendra për të Drejta të Barabarta/Grupi i Politikave të Migracionit, Bruksel, 2009.

131 ECRI, *CRI(2012)48*, fq. 22 [anglisht].

e testimi të situatës. Ndaj, IKDNJ-të dhe IKB-të, bashkë me OSHC-të rome dhe sinti dhe aktorë të tjerë, duhet të kërkojnë, brenda kufijve të mandateve të tyre, miratimin e një kuadri rregullator gjithëpërfshirës mbi testimin e situatës, që siguron që gjetjet të jenë të pranueshme si prova. Një çështje në të cilën një OSHC ka përdor testimin e situatës për të zbuluar diskriminimin është aktualisht në pritje për t'u gjykuar nga GJEDNJ-ja.¹³² Vendimi i GJEDNJ-së pritet të ketë pasoja të rëndësishme për legjitimimin dhe pranueshmërinë e testimi të situatës, veçanërisht duke pasur parasysh qasjen më kufizuese të GJED-së.¹³³

IKDNJ-të dhe IKB-të mund të ofrojnë trajnime mbi testimin e situatës për OSHC-të e komunitetit romë dhe sinti, dhe t'i inkurajojnë ato ta përdorin këtë metodë në aktivitetet e tyre ose të koordinohen me ta për hartimin e një plani testi, nëse e lejon mandati i tyre. Është thelbësore të sigurohet që testi i situatës i kryer nga OSHC-të të zhvillohet vetëm në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi ka botuar një seri udhëzuesish dhe ka zhvilluar trajnime për OSHC-të mbi testimin e situatës.¹³⁴

Në qershor 2024, **EQUINET-i** organizoi një seminar për IKB-të që përdorin ose po konsiderojnë të përdorin testimin e situatës. Seminari synonte të rriste nivelin e përdorimit të testimi të situatës dhe të përmirësonte efektshmërinë e punës së tyre ligjore, politikëbërëse, kërkimore dhe ndërgjegjësuese. Ai gjithashtu ofroi mundësi për IKB si UNIA (Belgjikë), Agjencia Federale Kundër Diskriminimit (Gjermani), Avokati i Popullit për Trajtim të Barabartë (Austri) dhe Avokati Publik i të Drejtave (Republika Çeke) për të shkëmbyer praktika të mira.¹³⁵

132 OSHC-ja Kham Delchevo dhe të tjerët kundër Maqedonisë së Veriut, Nr. 34791/17, komunikuar më 2 shtator 2019 [anglisht].

133 Megjithatë, shih vendimin e GJDBE-së C-423/15, Nils-Johannes Kratzer kundër R+V Allgemeine Versicherung AG, 28 korrik 2016, në të cilën GJDBE vlerësoi se përdorimi i testimi të situatës nga një person që nuk synonte ta pranonte një vend pune edhe nëse i otrohej, por e kryente testimin e situatës thjesht për të kërkuar kompensim, mund të konsiderohej keqpërdorim i të drejtave [anglisht].

134 EQUINET, Përfshirja e Romëve dhe Shtegtarëve, fq. 14 [anglisht].

135 Përmbledhje e Trajnimit EQUINET [anglisht].

4.5 Dhënia më shumë rëndësi raportimit tek organet dhe mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë të drejtave të njeriut

Raportimi mbi situatën e të drejtave të njeriut në vend tek mekanizmat dhe organet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut ndihmon për të ndarë njohuritë dhe rritur ndërgjegjësimin mbi mangësitë që ka vendi në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut.¹³⁶ IKDNJ-të dhe IKB-të duhet **të marrin pjesë aktivisht në konsultimet kombëtare**, për të garantuar që përvoja dhe ekspertiza e tyre do të pasqyrohen në raportimin në nivel kombëtar. Ato duhet gjithashtu **të zhvillojnë konsultime me shoqërinë civile dhe të hartojnë rekomandime SMART**. Megjithatë, ato duhet gjithashtu të synojnë të paraqesin raportimin dhe rekomandimet e tyre të pavarura.¹³⁷

Raportimi i pavarur dhe i bazuar në prova duhet të jetë hapi i parë kur ndërmerret çfarëdo veprimi drejt përmirësimit të situatës së të drejtave të njeriut në një shtet pjesëmarrës. Paralelisht, raportimi në nivel rajonal dhe ndërkombëtar është një mënyrë frytdhënëse për të tërhequr në nivel ndërkombëtar vëmendjen ndaj çështjeve kombëtare të të drejtave të njeriut, dhe mund të ndihmojë për të rritur presionin mbi shtetin përkatës për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut.

IKDNJ-të dhe IKB-të mund të paraqesin raporte paralele tek **organet e OKB-së të bazuara në traktate** (si CERD, CEDAW, CRC, CRPD, e të tjera)¹³⁸ dhe tek **organet e bazuara në Kartën e OKB-së**, kryesisht **Rishikimi Periodik Universal (UPR)**¹³⁹ dhe **Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së**.¹⁴⁰ Të gjitha IKDNJ-të dhe IKB-të jo vetëm që mund të paraqesin raporte te organet e traktateve të OKB-së, por edhe mund të ofrojnë informacione të tjera përmes të gjitha fazave të procesit të monitorimit, përfshirë edhe informime për anëtarët e organeve të monitorimit të traktateve, duke dhënë rekomandime dhe marrë pjesë në dialogun ndërveprues me shtetin pjesëmarrës.¹⁴¹

136 Për më shumë shih *Legjislacioni Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Sistemi Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut: Udhëzues për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut*; Forumi i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të Azisë dhe Paqësorit, 2012 [anglisht].

137 Për të mësuar më shumë rreth raportimit dhe formulimit të rekomandimeve SMART, ju lutemi shihni, *Raportimi për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut*, Instituti për të Drejtat e Njeriut në Danimarkë dhe *Monitorimi dhe raportimi* (kurs në internet për IKDNJ-të), GANHRI.

138 Për më shumë shih, *Raportimi tek Organet e Traktateve të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara: Manual*, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), 2017 [anglisht].

139 *Pjesëmarrja e IKDNJ-ve në Rishikimin Periodik Universal* (shënim informativ në internet), OHCHR [anglisht].

140 *Pjesëmarrja e IKDNJ-ve në Rishikimin Periodik Universal* (shënim informativ në internet), OHCHR [anglisht].

141 IKDNJ-të dhe IKB-të mund të kontribuojnë, gjithashtu, në përgatitjen e 'komenteve të përgjithshme' dhe 'rekomandimeve të përgjithshme' që nxjerrin organet monitoruese të traktateve.

Po kështu, çdo IKDNJ dhe IKB mund të ofrojë “informacion të besueshëm”¹⁴² për Rishikimin Periodik Universal të OKB-së (UPR). Për më tepër, IKDNJ-të me ‘status A’¹⁴³ kanë të drejta të gjera pjesëmarrjeje në UPR. Ato mund të marrin pjesë në debatin e seancës plenare të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, që ka të bëjë me miratimin e raporteve të Grupit të Punës të UPR-së, ku IKDNJ-ja (e shtetit në shqyrtim) ka të drejtë të marrë fjalën në seancën plenare të Këshillit menjëherë pas shtetit në shqyrtim.¹⁴⁴ Në përgjithësi, IKDNJ-të me ‘status A’ kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo seancë të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, ku kanë të drejtë të bëjnë deklarata verbale, personalisht ose përmes lidhjeve me video.¹⁴⁵ Së fundi, të gjitha IKDNJ-të dhe IKB-të mund të bashkëpunojnë gjithashtu me strukturat e veçanta, për shembull duke ofruar informacion dhe ndihmë në planifikimin dhe kryerjen e një vizite në një vend të caktuar.¹⁴⁶

Për sa u përket mekanizmave rajonalë të të drejtave të njeriut, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të marrin në konsideratë angazhimin me **ECRI-n** e Këshillit të Evropës, **Komitetin Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** dhe/ose **Komitetin Evropian të të Drejtave Sociale** (ECSR). IKDNJ-të dhe IKB-të mund të mbështesin punën monitoruese të ECRI-t duke ofruar informacionin e nevojshëm para një vizite monitoruese dhe duke u takuar me anëtarët e ECRI-t gjatë vizitës për të diskutuar mbi situatën e vendit në mënyrë të detajuar, si dhe duke u angazhuar për zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të ECRI-t pas çdo cikli monitorimi.¹⁴⁷ IKDNJ-të dhe IKB-të nuk mund të paraqesin vetë ankesa kolektive pranë ECSR-së, por ato mund t’i nxisin autoritetet vendore të nënshkruajnë Protokollin Opsional të Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar dhe të informojnë ECSR-në se kanë interes të paraqesin vëzhgime si palë të treta në lidhje me një ankesë kolektive në shqyrtim e sipër. Në lidhje me procedurën e rregullt të raportimit, ato mund të paraqesin në ECSR komente mbi raportet kombëtare ose informacione shtesë mbi shtetin pjesëmarrës në shqyrtim, dhe mund të bëjnë të njohura përfundimet dhe rekomandimet e ECSR-së.¹⁴⁸

142 Për më shumë shih, [Roli i Organeve të Barazisë në UPR](#), EQUINET, 2020 [anglisht].

143 IKDNJ-të që vlerësohen se janë në përputhje me Parimet e Parisit certifikohen me ‘statusin A’, ndërsa ato që u përmbahen atyre pjesërisht certifikohen me ‘statusin B’. IKDNJ-të me ‘statusin A’ kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë të pavarur në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, organet e tij të varësisë, dhe disa organe dhe mekanizma të Asamblesë së Përgjithshme. Shih [Akreditimi](#), GANHRI [anglisht].

144 [Përgjegjësitë e IKDNJ-ve: Angazhimi në sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut](#), GANHRI [anglisht].

145 Po aty.

146 Po aty.

147 [Organet e Barazisë](#), ECRI [anglisht].

148 [Si mund të bashkëpunojnë Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Organet Kombëtare të Barazisë me Komitetin Evropian të të Drejtave Sociale](#), Këshilli i Evropës, Strasburg, shtator 2021 [anglisht].

Megenëse kjo kërkon kohë dhe burime, IKDNJ-ve dhe IKB-ve u rekomandohet të ndjekin nga afër ciklet e raportimit dhe, **veçmas ose së bashku, të hartojnë dhe dorëzojnë raporte paralele** mbi çështje që kanë të bëjnë me punën dhe ekspertizën e tyre. Këto raporte duhet të publikohen në faqet e tyre në internet dhe të shpërndahen (edhe përmes medias) bashkë me raportet vjetore kombëtare, për të nxitur diskutimin publik mbi gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Për të ndjekur procesin, IKDNJ-të dhe IKB-të duhet të monitorojnë zbatimin e rekomandimeve, të bisedojnë dhe bashkëpunojnë me qeverinë për të siguruar zbatimin e tyre, dhe të kontribuojnë në hartimin e legjislacionit, politikave, kornizave institucionale ose programeve.

Shumë IKDNJ dhe IKB hartojnë dhe paraqesin rregullisht raporte paralele tek organet dhe mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut. Për shembull, **UNIA dhe Qendra Federale e Migracionit në Belgjikë (MYRIA)**, paraqitën së bashku raporte paralele te Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave dhe te Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.¹⁴⁹ **CNCDH-ja e Francës** nxori një raport mbi Listën e Çështjeve që kanë të bëjnë me Francën të trajtuara nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës,¹⁵⁰ ndërsa **Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut në Britaninë e Madhe dhe GNCHR-ja në Greqi** i paraqitën Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor raportet e tyre me vëzhgime mbi raportet e vendeve përkatëse,¹⁵¹ dhe **Avokati i Popullit në Spanjë** i dha informacion Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore për përgatitjen e Listës së Çështjeve të Komitetit Para Raportimit.¹⁵² Po kështu, **Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë në Irlandë** i dorëzoi ECRI-t një raport.¹⁵³ Këto raporte, shpesh kritike ndaj qeverisë, paraqiten pranë organeve të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale. Për këtë arsye është e rëndësishme që IKDNJ-të dhe IKB-të të paraqesin raporte dhe rekomandime të pavarura.

149 Raporti paralel i IKDNJ-ve UNIA dhe MYRIA, 2022

150 Përgjigja e CNCDH-së së Francës ndaj pyetësorit.

151 Material dorëzuar Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor në Britaninë e Madhe, Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut të Britanisë së Madhe, korrik 2024; Vëzhgime mbi raportin periodik të kombinuar të 23-të dhe 24-të të Greqisë drejtuar Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, GNCHR, korrik 2021 [anglisht].

152 Përgjigja nga Avokati i Popullit në Spanjë.

153 Raporti "Irlanda dhe Cikli i 6-të i Monitorimit i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës", Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë në Irlandë, qershor 2024 [anglisht].

Në vitin 2015, **Këshilli i Evropës (KiE), FRA, ENNHRI** dhe **EQUINET-i** krijuan një platformë të përbashkët mbi të drejtat sociale dhe ekonomike.¹⁵⁴ Platforma ka për qëllim të mbështesë IKDNJ-të dhe IKB-të, për të forcuar zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare që lidhen me të drejtat sociale dhe ekonomike, përfshirë gjetjen e zgjidhjeve për sfidat kryesore ndaj të drejtave themelore që lidhen me romët dhe sintët.

154 Për më shumë shih, Këshilli i Evropës, [Rreth Platformës së KiE-FRA-ENNHRI-EQUINET-it mbi të drejtat sociale dhe ekonomike](#) [anglisht].

SHTOJCA 1: Burime shtesë për IKDNJ-të dhe IKB-të¹⁵⁵

- Akademia e të Drejtës Evropiane, Hyrje në të Drejtën e BE-së kundër Diskriminimit (Introduction to EU Anti-Discrimination Law), qasje falas.
- Edukimi mbi të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë i Këshillit të Evropës (HELP), ([Course on Anti-discrimination](#)). Ju lutemi, vini re se HELP përmban shumë kurse të tjera mbi romët dhe sintët ose çështje të lidhura me to, disa prej të cilave kanë të bëjnë me vende të caktuara.
- Këshilli i Evropës, Tekst Mësimor mbi të Drejtën kundër Diskriminimit ([Textbook on Anti-discrimination Law](#)), 2024.
- Këshilli i Evropës, Fuqizimi i grave rome dhe shtegtare: Ndryshim në rrugë e sipër – Drejt një Udhërrëfyese për Përparimin e Barazisë Gjinore të Grave Rome dhe Shtegtare në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ([Empowerment of Roma and Traveller women: a change under construction - Towards a Roadmap for Advancing Gender Equality of Roma and Traveller Women in Council of Europe member states](#)), 2021.
- Këshilli i Evropës, Manual për mbrojtësit ligjorë të romëve dhe shtegtarëve ([A Handbook for lawyers defending Roma and Travellers](#)), 2016.
- Këshilli i Evropës, Manuali i Trajnerit ROMED1 – Programi evropian i trajnimit mbi ndërmjetësimin ndërkulturor për komunitetet rome ([ROMED1 Trainer's Handbook - European training programme on intercultural mediation for Roma communities](#)), 2016.
- Këshilli i Evropës, Pasqyrat – Manual për luftën kundër anticiganizmit përmes edukimit mbi të drejtat e njeriut ([Mirrors - Manual on combating antigypsyism through human rights education](#)), 2015.

155 Lista e burimeve shtesë për IKDNJ-të dhe IKB-të duhet parë si një listë [joshteruese](#) e materialeve që mund të konsiderohen të vlefshme për punonjësit e IKDNJ-ve dhe IKB-ve në punën e tyre me çështjet e komuniteteve rome dhe sinti, duke u përqendruar veçanërisht në trajtimin e diskriminimit të përhapur të romëve dhe sintëve në rajonin e OSBE-së.

- Këshilli i Evropës, DOSTA! Mjaft! Shko përtej paragjytimeve, tako romët!: Set mjetesh kundër anticiganizmit ([DOSTA! Enough! Go beyond prejudice, meet the Roma!: Toolkit against anti-Gypsyism](#)), 2014.
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Fletëpalosje me fakte – Romët dhe Shtegtarët ([Factsheet – Roma and Travellers](#)), 2024.
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut/Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Manual mbi legjislacionin evropian kundër diskriminimit ([Handbook on European non-discrimination law](#)), 2018.
- Rrjeti Evropian i Legjislacionit për Barazinë, Analizë krahasuese e legjislacionit kundër diskriminimit në Evropë 2023 ([A comparative analysis of non-discrimination law in Europe 2023](#)), 2024.
- Rrjeti Evropian i Legjislacionit për Barazinë, Diskriminimi indirekt sipas Direktivave 2000/43 dhe 2000/78 ([Indirect discrimination under Directives 2000/43 and 2000/78](#)), 2022.
- Rrjeti Evropian i Legjislacionit për Barazinë, Diskriminimi racor në arsim dhe legjislacioni i BE-së për barazinë ([Racial discrimination in education and EU equality law](#)), 2020.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Udhëzime Bazë për të Përmirësuar Mbledhjen e të Dhënave mbi Ankesat nga Organet e Barazisë ([Minimal Guidelines on Improving Complaints Data Collection by Equality Bodies](#)), 2023.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Puna e organeve të barazisë në rastet pa viktimë të identifikueshme: Actio popularis ([Equality Bodies working on cases without an identifiable victim: Actio popularis](#)), 2022.

- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Trajtimi i Racizmit Institucional. Përbushja e Potencialit të Organeve të Barazisë ([Tackling Institutional Racism. Realising the Potential of Equality Bodies](#)), 2021.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Përmbledhje e Praktikave të Mira mbi Integrimin e Barazisë: Përdorimi i Detyrimeve për Barazi dhe Vlerësimeve të Ndikimit në Barazi ([Compendium of Good Practices on Equality Mainstreaming: The Use of Equality Duties and Equality Impact Assessments](#)), 2021.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Përfshirja e Romëve dhe Shtegtarëve: Drejt një Kuadri të ri të BE-së bazuar në Mësimet e Nxjerra nga Puna e Organeve të Barazisë ([Roma and Traveller Inclusion: Towards a new EU Framework Learning from the Work of Equality Bodies](#)), 2020.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Çështje të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi Nenin 14 ([Article 14 Cases from the European Court of Human Rights](#)), 2020.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Përmbledhje e Praktikave të Mira mbi Profilizimin Etnik ([Compendium of Promising Practices on Ethnic Profiling](#)), 2019.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Organet e barazisë që trajtojnë gjuhën e urrejtjes ([Equality bodies addressing hate speech](#)), 2018.
- Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, Legjislacioni për barazinë funksionon në praktikë për romët dhe shtegtarët ([Making equality legislation work for Roma and Travellers](#)), 2010.
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Realizimi i të drejtave ekonomike dhe sociale në Evropë: Këshilla për IKDNJ-të, Seminare në internet ([Realising economic and social rights in Europe: Tips and tricks for NHRIs, Webinar series](#)).

- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Praktikrat e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në Evropë në lidhje me të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, mjet online ([Economic and Social Rights Practices of National Human Rights Institutions in Europe, Online Tool](#)), 2019.
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Një Qasje e Bazuar në të Drejtat e Njeriut për Uljen dhe Matjen e Varfërisë: Udhëzues për IKDNJ-të ([Applying a Human Rights-Based Approach to Poverty Reduction and Measurement: A guide for NHRIs](#)), 2019.
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Gëzimi i të Drejtave Ekonomike dhe Sociale nga Migrantët: Praktikrat e Mira dhe Sfidat e IKDNJ-ve ([Migrants' Access to Economic and Social Rights: Good Practices and Challenges of NHRIs](#)), 2019.
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Si mund t'i trajtojnë IKDNJ-të të drejtat ekonomike dhe sociale në periudhat pas konflikteve? ([How can NHRIs address economic and social rights in \(post-\) conflict situations?](#)), 2019.
- Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Puna me Romët: Pjesëmarrja dhe fuqizimi i komuniteteve vendore ([Working with Roma: Participation and empowerment of local communities](#)), 2018.
- Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Një shqetësim i vazhdueshëm: anticiganizmi si pengesë për përfshirjen e romëve ([A persisting concern: anti-Gypsyism as a barrier to Roma inclusion](#)), 2018.

